Mësimdhënësit përballen me kërkesa të shumta profesionale që mund të ndikojnë në mirëqenien emocionale, motivimin dhe cilësinë e procesit mësimor. Krahas mësimdhënies, ata kryejnë detyra administrative, si dokumentimi pedagogjik, planifikimet, raportimet dhe evidencat, të cilat kërkojnë kohë dhe angazhim shtesë. Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizojë ndikimin e ngarkesës administrative në stresin dhe mirëqenien emocionale të mësimdhënësve, si dhe në motivimin, përkushtimin profesional dhe cilësinë e procesit mësimor në arsimin parauniversitar në Kosovë. Hulumtimi mbështetet në qasjen cilësore. Të dhënat janë mbledhur përmes fokus-grupeve me mësimdhënës dhe janë analizuar përmes analizës tematike. Rezultatet paraprake tregojnë se ngarkesa administrative perceptohet si pjesë e vazhdueshme e punës, veçanërisht për shkak të planifikimeve, evidencave, raportimeve dhe vlerësimeve. Pjesëmarrësit raportojnë se këto detyra shpesh realizohen jashtë orarit të punës, duke kufizuar kohën e lirë dhe kohën për

Abstract

Teachers face numerous professional demands that can affect their emotional well-being, motivation, and the quality of the teaching process. In addition to teaching, they carry out administrative tasks such as pedagogical documentation, lesson planning, reporting, and record-keeping which require extra time and effort. The purpose of this research is to analyze the impact of administrative burden on the stress and emotional well-being of teachers, as well as on their motivation, professional commitment, and the quality of the teaching process within pre-university education in Kosovo. The research employs a qualitative approach. Data were collected through focus groups with teachers and analyzed using thematic analysis. Preliminary results indicate that administrative workload is perceived as an ongoing part of the job, particularly due to planning, record-keeping, reporting, and assessment tasks. Participants report that these tasks are often carried out outside of working hours limiting both their free time and time available for

përgatitjen e mësimit, si dhe shoqërohen me stres, lodhje, tension dhe frustrim. Ndikimi në motivim ndryshon ndërmjet pjesëmarrësve: disa ruajnë përkushtimin profesional pavarësisht lodhjes, ndërsa të tjerë raportojnë ulje të energjisë dhe motivimit. Ngarkesa administrative, gjithashtu, kufizon kohën dhe energjinë për aktivitetet mësimore dhe mbështetjen individuale të nxënësve. Pjesëmarrësit propozojnë thjeshtimin dhe digjitalizimin e dokumentacionit, koordinimin e kërkesave administrative dhe fuqizimin e mbështetjes institucionale. Gjetjet sugjerojnë nevojën për rishikimin e praktikave administrative për të mbështetur mirëqenien profesionale dhe punën pedagogjike të mësimdhënësve.

***Fjalët çelës**:* mësimdhënësit, ngarkesa administrative, mirëqenia emocionale, stresi profesional, burnout (lodhja profesionale), zhvillimi profesional.

lesson preparation and are accompanied by stress, fatigue, tension, and frustration. The impact on motivation varies among participants: some maintain their professional commitment despite the fatigue, while others report a decline in energy and motivation. Administrative burden also limits the time and energy available for teaching activities and individual student support. Participants propose simplifying and digitizing documentation, coordinating administrative requirements, and strengthening institutional support. The findings suggest a need to review administrative practices in order to support teachers' professional well-being and pedagogical work.

Keywords: teachers, administrative workload, emotional well-being, occupational stress, burnout, professional development.

Integrimi i zhvillimit të kompetencës së të kuptuarit të leximit në Planin Zhvillimor të Shkollës: Studim rasti krahasues në Kosovë dhe në Estoni

Integrating the Development of Reading Comprehension Competence into the School Development Plan: A Comparative Case Study in Kosovo and Estonia

Ardiana Selimi
OJQ-ja The Library Project Kosova / The NGO The Library Project Kosova
E-mail: ardiana.selimi10@gmail.com

Abstrakt

Plani Zhvillimor i Shkollës përbën një mekanizëm kyç për orientimin strategjik dhe përmirësimin e vazhdueshëm të shkollës. Megjithëse ekzistojnë qasje të ndryshme në hartimin e tyre, Plani Zhvillimor i Shkollës duhet të reflektojë qëllime relevante në përputhje me nevojat e shkollës. Duke reflektuar nevojën për përmirësim dhe rëndësinë e të kuptuarit të leximit, si një nga aftësitë themelore për suksesin akademik të nxënësve dhe zhvillimin e potencialit të tyre të plotë, qëllimi i këtij hulumtimi ishte të shqyrtojë se si integrohet kjo kompetencë në Planin Zhvillimor të Shkollës në dy kontekste të ndryshme arsimore: në Estoni dhe në Kosovë. Studimi u zhvillua me një qasje cilësore, përmes dizajnit të studimit të rastit të shumëfishtë, me qëllim ofrimin e një pasqyre të gjerë dhe të thelluar mbi proceset e planifikimit të kësaj kompetence. Mostra e hulumtimit është përbërë nga katër shkolla, dy në Kosovë dhe dy në Estoni, të përzgjedhura në mënyrë të qëllimshme. Pjesëmarrës në studim janë drejtorët e shkollave, zëvendësdrejtorët, pedagogët apo mësim-dhënësit, të cilët janë drejtpërdrejt të përfshirë në

Abstract

The School Development Plan serves as a key mechanism for the strategic orientation and continuous improvement of a school. Although there are various approaches to drafting such plans, a School Development Plan should reflect relevant goals that align with the school's specific needs. Given the need for improvement and the importance of reading comprehension a fundamental skill for students' academic success and the realization of their full potential this research aimed to examine how this competency is integrated into the School Development Plan within two distinct educational contexts: Estonia and Kosovo. The study employed a qualitative approach, utilizing a multiple-case study design, with the aim of providing a comprehensive and in-depth overview of the planning processes related to this competency. The research sample consisted of four schools two in Kosovo and two in Estonia selected through purposive sampling. Participants in the study included school principals, deputy principals, and teachers who are directly involved in this process. Data were collected

këtë proces. Të dhënat janë mbledhur përmes intervistave gjysmë të strukturuara dhe përmes analizës së dokumenteve shkollore, kurse analizimi i tyre është bërë përmes analizës tematike. Hulumtimi u mbështet në Teorinë e përmirësimit të shkollës të Fullan dhe përdori udhëheqjen pedagogjike si perspektivë analitike për të shqyrtuar rolin e drejtorit në këtë proces. Gjetjet tregojnë se në shkollat e përzgjedhura në Estoni kompetenca e të kuptuarit të leximit është e integruar më qartë në planet zhvillimore si prioritet i përbashkët institucional, e shoqëruar me një orientim më të theksuar drejt zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe përmirësimit të praktikave mësimore. Në rastet e shqyrtuara në Kosovë, kjo kompetencë shfaqet më pak e artikuluar si objektiv i përbashkët zhvillimor, duke u trajtuar më shumë përmes praktikave të veçanta mësimore sesa përmes një qasjeje të koordinuar në nivel shkolle. Të interpretuara sipas kornizës së ndryshimit, gjetjet në të dy kontekstet theksojnë nevojën e integrimit sistematik të objektivave të përbashkëta, vendosjen e të nxënit dhe arritjeve të nxënësve në qendër të planifikimit, si dhe ndërtimin e kapaciteteve individuale e kolektive përmes zhvillimit profesional dhe bashkëpunimit institucional.

Fjalët çelës: Plani Zhvillimor i Shkollës, kompetenca e të kuptuarit të leximit, studim rasti, udhëheqja e shkollës.

through semi-structured interviews and the analysis of school documents, while the analysis itself was conducted using thematic analysis. The research was grounded in Fullan's school improvement theory and employed pedagogical leadership as an analytical lens to examine the principal's role in this process. The findings indicate that, in the selected schools in Estonia, reading comprehension competence is more explicitly integrated into development plans as a shared institutional priority, accompanied by a stronger focus on teachers' professional development and the enhancement of instructional practices. In the cases examined in Kosovo, this competency appears less clearly articulated as a shared developmental objective; it is addressed more through specific instructional practices than through a coordinated, school-wide approach. Interpreted through the lens of a change framework, the findings in both contexts underscore the need for the systematic integration of shared goals, the placement of student learning and achievement at the heart of planning, and the building of individual and collective capacity through professional development and institutional collaboration.

***Keywords*:** School Development Plan, reading comprehension competence, case study, school leadership.

Ndikimi i kontekstit kulturor të teksteve shkollore në leximin me kuptim në orën e gjuhës angleze

The influence of the cultural context of school textbooks on reading comprehension in English language lessons

Azra Thaqi Gashi, PhDc
Asistente e angazhuar – Universiteti "Ukshin Hoti", Prizren / Part-time Assistant – "Ukshin Hoti" University, Prizren
E- mail: Azrathaqi12@gmail.com; azra.thaqi@uni-prizren.com

Ermal Thaqi
Student i nivelit master - "SEEU: South East European University", North Macedonia
Master's level student - "SEEU: South East European University", North Macedonia
E- mail: thaqiermal333@gmail.com

Abstrakt

Zhvillimi i shkathtësisë së leximit me kuptim (reading comprehension) në gjuhën angleze, si gjuhë e huaj (EFL), është një nga pikat më sfiduese në procesin mësimor. Tekstet shkollore ndërkombëtare, që përdoren gjerësisht në Kosovë, ndonëse gjuhësisht të pasura, shpesh mbështeten në një kontekst kulturor global ose ekskluzivisht perëndimor. Ky punim synon të hulumtojë se si përshtatshmëria kulturore e materialeve tekstuale ndikon në aftësinë e nxënësve për të zbërthyer dhe kuptuar saktë një tekst, duke analizuar hendekun midis përmbajtjes globale të librit dhe identitetit kulturor të nxënësit.

Përmes një qasjeje empirike, hulumtimi analizon performancën dhe perceptimet e nxënësve gjatë trajtimit të dy llojeve të teksteve: teksteve standarde me referenca të huaja kulturore dhe teksteve të përshtatura që ndërlidhen me kulturën dhe realitetin shqiptar. Po ashtu, punimi përfshin një pyetësor me mësimdhënës të gjuhës angleze

Abstract

Developing reading comprehension skills in English as a Foreign Language (EFL) is one of the most challenging aspects of the learning process. International textbooks, which are widely used in Kosovo, are linguistically rich but often rely on a global or exclusively Western cultural context. This paper aims to investigate how the cultural appropriateness of textual materials influences students' ability to accurately decode and comprehend a text, by analyzing the gap between the global content of the textbook and the students' own cultural identity.

Through an empirical approach, the research analyzes students' performance and perceptions when engaging with two types of texts: standard texts containing foreign cultural references, and adapted texts that relate to Albanian culture and reality. Furthermore, the study includes a questionnaire for English language teachers

mbi strategjitë që ata i përdorin për të kapërcyer këto barriera kulturore në klasë.

Rezultatet tregojnë se njohuritë paraprake kulturore luajnë një rol përcaktues në kuptueshmërinë e leximit; nxënësit shfaqin angazhim më të lartë dhe performancë më të mirë kur teksti reflekton pika referimi të njohura për ta. Si përfundim, punimi argumenton se zhvillimi profesional i mësimdhënësve duhet të fokusohet në ngritjen e kompetencave të tyre për lokalizimin dhe adaptimin kritik të teksteve shkollore, duke siguruar që procesi i leximit të jetë kuptimplotë dhe gjithëpërfshirës për nxënësit në Kosovë.

Fjalët çelës: lexim me kuptim, tekste shkollore, lokalizim kulturor, gjuhë angleze, zhvillim profesional

regarding the strategies they employ to overcome these cultural barriers in the classroom.

The results indicate that prior cultural knowledge plays a decisive role in reading comprehension; students demonstrate greater engagement and better performance when a text reflects points of reference familiar to them. Consequently, the paper argues that teachers' professional development should focus on enhancing their competence in localizing and critically adapting textbooks, thereby ensuring that the reading process is meaningful and inclusive for students in Kosovo.

Keywords: reading comprehension, school textbooks, cultural localization, English language, professional development

Roli i trajnimeve në formësimin e identitetit profesional dhe zhvillimin e kompetencave udhëheqëse të zëvendësdrejtorëve të shkollave profesionale në Kosovë

The role of training in shaping the professional identity and developing the leadership competencies of deputy principals in vocational schools in Kosovo

Bashkim Ali Azemi
Instituti Pedagogjik i Kosovës / Pedagogical Institute of Kosovo
E- mail: alifazliazemi@gmail.com
Edona Vojvoda
Instituti Pedagogjik i Kosovës / Pedagogical Institute of Kosovo
E- mail: Edona.Vojvoda@rks-gov.net

Abstrakt

Zhvillimi profesional është aspekt qendror për udhëheqjen e suksesshme, veçanërisht në arsimin profesional. Profesionistët arsimorë që ushtrojnë funksione udhëheqëse në shkolla vazhdojnë t'i perceptojnë trajnimet kryesisht si mundësi për përfitimin e njohurive pedagogjike. Megjithatë, ndikimi i trajnimeve profesionale shtrihet përtej këtij dimensioni, duke përfshirë zhvillimin e kompetencave profesionale, përshtatjen ndaj ndryshimeve dhe formësimin e një identiteti të ri udhëheqës. Në këtë kontekst, relevanca e trajnimeve, mundësitë për zbatimin e njohurive të fituara dhe konteksti në të cilin veprojnë udhëheqësit ndikojnë në mënyrën se si të nxënit profesional përkthehet në përmirësimin e praktikës reale. Ky studim mëton të shqyrtojë rolin e trajnimeve profesionale në zhvillimin e kompetencave udhëheqëse, me fokus në ushtrimin e rolit udhëheqës, aplikimin e njohurive të fituara dhe zbatimin e ekspertizës profesionale

Abstract

Professional development is a central aspect of successful leadership, particularly in vocational education. Educational professionals in leadership roles within schools often perceive training primarily as an opportunity to acquire pedagogical knowledge. However, the impact of professional training extends well beyond this dimension, encompassing the development of professional competencies, adaptation to change, and the shaping of a new leadership identity. In this context, the relevance of training, the opportunities to apply acquired knowledge, and the environment in which leaders operate influence how professional learning translates into the improvement of actual practice. This study aims to examine the role of professional training in the development of leadership competencies, with a focus on the exercise of the leadership role, the application of acquired knowledge, and the implementation of professional expertise in practice. Qualitative data were collected through

në praktikë. Të dhënat cilësore janë mbledhur përmes intervistave gjysmë të strukturuara, duke përfshirë si mostër 15 zëvendësdrejtorë me përvojë në udhëheqjen e shkollave profesionale dhe pjesëmarrje në trajnime profesionale gjatë karrierës së tyre. Përmes analizës tematike, janë shqyrtuar perceptimet e zëvendësdrejtorëve mbi kontributin e trajnimeve në të nxënit profesional, zhvillimin e kompetencave dhe ndikimin e tyre në praktikën udhëheqëse. Rezultatet tregojnë se trajnimet profesionale kanë kontribuuar në përmirësimin e praktikave profesionale, forcimin e kompetencave pedagogjike dhe menaxheriale, rritjen e kapaciteteve për udhëheqje më efektive dhe nxitjen e reflektimit mbi rolin dhe përgjegjësitë e tyre si udhëheqës. Studimi nënvizon rëndësinë e programeve të trajnimit profesional të orientuara drejt praktikës dhe të përshtatura me nevojat e kontekstit të shkollave profesionale në Kosovë.

Fjalët çelës: zëvendësdrejtor, shkollë profesionale, trajnim, efektivitet, udhëheqje.

semi-structured interviews with a sample of 15 deputy principals who possess experience in leading vocational schools and have participated in professional training throughout their careers. Through thematic analysis, the study examined the deputy principals' perceptions regarding the contribution of training to professional learning and the development of competencies, as well as its impact on their leadership practice. The results indicate that professional training has contributed to improving professional practices, strengthening pedagogical and managerial competencies, enhancing capacities for more effective leadership, and fostering reflection on the roles and responsibilities of leaders. The study underscores the importance of practice-oriented professional training programs that are tailored to the specific needs and context of vocational schools in Kosovo.

Keywords: deputy director, vocational school, training, effectiveness, leadership.

Roli i transformimit digjital dhe udhëheqjes arsimore në zhvillimin profesional të mësimdhënësve

The role of digital transformation and educational leadership in the professional development of teachers

Bekim Paci
Profesor i lëndës së Historisë në gjimnazin "Eqrem Çabej" – Prishtinë
E- mail: bekimpaci@hotmail.com

Valon Hoxha
Drejtor në shkollën fillore private "Akademia Ora" – Prishtinë
E- mail: valonhoxha007@gmail.com

Abstrakt

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve përbën një faktor me rëndësi për rritjen e cilësisë në arsim, veçanërisht në kontekstin e transformimeve të shpejta digjitale. Në kontekstin e Kosovës, ky proces është ndikuar nga ndërveprimi i transformimit digjital me praktikat pedagogjike dhe roli i udhëheqjes arsimore në nivel institucional.

Ky punim ka analizuar ndikimin e transformimit digjital dhe udhëheqjes arsimore në zhvillimin profesional të mësimdhënësve, duke identifikuar perceptimet, sfidat dhe faktorët që kanë ndikuar në integrimin efektiv të teknologjisë në mësimdhënie. Duke përdorur një qasje të kombinuar teorike dhe empirike, hulumtimi mbështetet në analizën e literaturës bashkëkohore, dokumenteve strategjike në Kosovë dhe të dhënave të mbledhura përmes një pyetësori të strukturuar me 36 mësimdhënës

Abstract

Professional development for teachers is a significant factor in enhancing the quality of education, particularly in the context of rapid digital transformation. In the case of Kosovo, this process has been shaped by the interplay between digital transformation and pedagogical practices, as well as the role of educational leadership at the institutional level.

This paper has analyzed the impact of digital transformation and educational leadership on the professional development of teachers, identifying the perceptions, challenges, and factors that have influenced the effective integration of technology into teaching. Employing a combined theoretical and empirical approach, the research draws upon an analysis of contemporary literature, strategic documents in Kosovo, and data collected via a structured questionnaire administered to 36 teachers from the "Eqrem Çabej" Gymnasium and

nga gjimnazi “Eqrem Çabej” dhe ShFMU “Akademia Ora”.

Rezultatet kanë treguar një perceptim të lartë pozitiv për rolin e teknologjisë në procesin mësimor, pasi shumica e mësimdhënësve kanë vlerësuar se integrimi i mjeteve digjitale e ka përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe e ka rritur angazhimin e nxënësve. Po ashtu, një pjesë e konsiderueshme e tyre janë ndier kompetentë për përdorimin e teknologjisë në klasë.

Megjithatë, gjetjet kanë sugjeruar se, me gjithë perceptimin e lartë pozitiv për rolin e teknologjisë në përmirësimin e procesit mësimor dhe angazhimit të nxënësve, ndikimi i saj në rezultatet e të nxënit nuk është perceptuar në mënyrë të njëtrajtshme nga të gjithë mësimdhënësit, pasi rezultatet kanë treguar mungesë të trajnimeve praktike dhe një nevojë të theksuar për mbështetje të vazhdueshme pedagogjike.

Në përfundim, hulumtimi ka theksuar se një qasje e integruar, e cila kombinon politikat arsimore, lidershipin efektiv dhe përdorimin strategjik të teknologjisë, mund të përmirësojë ndjeshëm performancën e mësimdhënësve dhe përvojën e të nxënit.

Fjalët çelës: zhvillim profesional, transformim digjital, udhëheqje arsimore, mësimdhënës.

the “Akademia Ora” Primary and Lower Secondary School.

The results have shown a highly positive perception regarding the role of technology in the learning process, as the majority of teachers have assessed that the integration of digital tools has improved the quality of teaching and increased student engagement. Furthermore, a significant proportion of them felt competent in using technology in the classroom.

However, the findings suggest that, despite a highly positive perception of the role of technology in enhancing the learning process and student engagement, its impact on learning outcomes is not perceived consistently by all teachers; the results indicate a lack of practical training and a pronounced need for ongoing pedagogical support.

In conclusion, the research has highlighted that an integrated approach combining educational policies, effective leadership, and the strategic use of technology can significantly improve teacher performance and the learning experience.

Keywords: professional development, digital transformation, educational leadership, teachers.

Integrimi i teknologjisë në mësimdhënie: përvojat dhe sfidat e mësimdhënësve në Kosovë

Integrating Technology into Teaching: Experiences and Challenges of Teachers in Kosovo

Blerona Sojeva
Hulumtuese e pavarur / Independent researcher
E- mail: bleronasojeva1@gmail.com

Fortesa Sojeva
Mësimdhënëse në American School of Kosovo / Teacher at the American School of Kosovo
E- mail: fortesa.sojeva1@gmail.com

Abstrakt

Në kontekstin e transformimit digjital në arsim, integrimi i teknologjisë është bërë pjesë e rëndësishme e praktikës mësimore. Ky studim analizon përvojat dhe sfidat e mësimdhënësve në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në Kosovë lidhur me përdorimin e teknologjisë digjitale. Studimi bazohet në një qasje sasiore dhe në të dhënat e mbledhura nga 118 mësimdhënës, përmes një pyetësori të strukturuar. Të dhënat u analizuan me statistika përshkruese, korrelacionin Spearman dhe testin Kruskal–Wallis. Rezultatet treguan se teknologjia përdoret relativisht shpesh, veçanërisht për prezantime në PowerPoint, video edukative dhe kërkim informacioni. U gjetën lidhje pozitive ndërmjet aftësive të perceptuara dhe shpeshtësisë së përdorimit ($\rho = .403$, $p < .001$), si dhe ndërmjet vetëbesimit dhe perceptimeve për integrimin e teknologjisë ($\rho = .557$, $p < .001$). Gjithashtu, u vunë re dallime në perceptime sipas

Abstract

In the context of digital transformation in education, the integration of technology has become an important part of teaching practice. This study analyzes the experiences and challenges of teachers in primary and lower secondary schools in Kosovo regarding the use of digital technology. The study employs a quantitative approach and utilizes data collected from 118 teachers via a structured questionnaire. The data were analyzed using descriptive statistics, Spearman correlation, and the Kruskal Wallis test. The results indicated that technology is used relatively frequently, particularly for PowerPoint presentations, educational videos, and information searching. Positive correlations were found between perceived skills and frequency of use ($\rho = .403$, $p < .001$), as well as between self-confidence and perceptions regarding technology integration ($\rho = .557$, $p < .001$). Furthermore, differences in

grupmoshës, por jo në shpeshtësinë e përdorimit. Gjetjet theksojnë rëndësinë e trajnimeve, mbështetjes profesionale dhe infrastrukturës teknologjike.

Fjalët çelës: integrimi i teknologjisë, mësimdhënia, arsimi parauniversitar, kompetencat digjitale, zhvillimi profesional.

perceptions were observed across age groups, though no such differences were found regarding the frequency of use. The findings underline the importance of training, professional support, and technological infrastructure.

***Keywords*:** technology integration, teaching, pre-university education, digital competencies, professional development.

Inteligjenca Artificiale dhe reflektimi në zhvillimin profesional të mësimdhënësve: studim rasti

Artificial Intelligence and reflection in the professional development of teachers: a case study

Blerta Mehmetaj, PhD Candidate,
Faculty of Philosophy, Saints Cyril and Methodius University in Skopje, Department: Pedagogy.
E-mail: bblerta.mehmetaj@hotmail.com

Medina Xhuraj, PhD Candidate,
Faculty of Philosophy, Saints Cyril and Methodius University in Skopje, Department: Pedagogy.
E-mail: medinaxhuraj@hotmail.com

Lena Damovska,
Professor at the Institute of Pedagogy, Faculty of Philosophy, Saints Cyril and Methodius University in Skopje.
E-mail: lenad@fzf.ukim.edu.mk

Abstrakt

Në kushtet e zhvillimeve të shpejta teknologjike dhe kërkesave në rritje për cilësi dhe inovacion në arsim, zhvillimi profesional i mësimdhënësve kërkon qasje të reja dhe më fleksibile. Në këtë kontekst, përdorimi i inteligjencës artificiale, i kombinuar me reflektimin profesional, paraqet një mundësi të rëndësishme për përmirësimin e praktikave mësimore në arsimin fillor. Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë rolin e Inteligjencës Artificiale dhe reflektimit profesional në mbështetjen e zhvillimit profesional të mësimdhënësve.

Studimi është realizuar përmes një qasjeje cilësore, duke përdorur metodën e studimit të rastit, të fokusuar në praktikën e një mësimdhënësi të arsimit fillor. Të dhënat janë mbledhur përmes

Abstract

Given rapid technological developments and growing demands for quality and innovation in education, the professional development of teachers requires new and more flexible approaches. In this context, the use of artificial intelligence, combined with professional reflection, presents a significant opportunity for improving teaching practices in primary education. The purpose of this study is to examine the role of artificial intelligence and professional reflection in supporting the professional development of teachers.

The study was conducted using a qualitative approach specifically a case study method focusing on the practice of a primary education teacher. Data were collected through direct

vëzhgimit të drejtpërdrejtë të orëve mësimore, analizës së planeve mësimore para dhe pas përdorimit të inteligjencës artificiale, shënimeve reflektuese dhe produkteve të nxënësve. Analiza e të dhënave është realizuar në mënyrë tematike, me qëllim identifikimin e ndryshimeve në planifikim, mësimdhënie dhe angazhimin e nxënësve.

Gjetjet tregojnë se përdorimi i Inteligjencës Artificiale ndihmon në rritjen e efikasitetit në planifikim, në krijimin e aktiviteteve më kreative dhe të diferencuara, si dhe në rritjen e angazhimit të nxënësve. Po ashtu, reflektimi profesional kontribuon në rritjen e vetëdijesimit të mësimdhënësit dhe mbështet përmirësimin e vazhdueshëm të praktikës së tij. Studimi përfundon se kombinimi i Inteligjencës Artificiale me reflektimin profesional përbën një qasje efektive për zhvillimin profesional dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor.

***Fjalët çelës*:** arsimi fillor, inteligjenca artificiale, reflektimi profesional, zhvillimi profesional, praktikat mësimore.

observation of lessons, analysis of lesson plans (both before and after the use of artificial intelligence), reflective notes, and student work. Data analysis was performed thematically, with the aim of identifying changes in lesson planning, teaching, and student engagement.

The findings indicate that the use of Artificial Intelligence helps increase efficiency in planning, facilitates the creation of more creative and differentiated activities, and boosts student engagement. Furthermore, professional reflection contributes to greater self-awareness among teachers and supports the continuous improvement of their practice. The study concludes that combining Artificial Intelligence with professional reflection constitutes an effective approach for professional development and for enhancing the quality of teaching in primary education.

***Keywords*:** primary education, artificial intelligence, professional reflection, professional development, teaching practices.

Transformimi digjital dhe Inteligjenca Artificiale në zhvillimin profesional të mësimdhënësve

Digital transformation and Artificial Intelligence in the professional development of teachers

Dijana Mehmeti
Mësimdhënëse në arsimin fillor, ShFMU "Daut Bogujevci"- Fushë Kosovë
Primary school teacher, "Daut Bogujevci" Primary and Lower Secondary School – Fushë Kosovë
E-mail: dijannamehmetii@gmail.com

Abstrakt

Transformimi digjital dhe Inteligjenca Artificiale (IA) po e ndryshojnë thellësisht sistemin arsimor global dhe rajonal, duke krijuar mundësi të reja për zhvillimin profesional të mësimdhënësve. Ky studim synon të analizojë rolin e mjeteve digjitale dhe IA-së në personalizimin e të nxënit, zhvillimin e aftësive digjitale dhe përmirësimin e praktikave mësimore. Pyetjet kryesore të ngritura janë: Në çfarë mase integrohen mjetet digjitale dhe IA në mësimdhënie? Cilat janë përfitimet dhe rreziqet e tyre pedagogjike? Si ndikon konteksti urban-rural në qasjen ndaj teknologjisë? Studimi mbështetet në qasje analitike dhe përshkruese, duke kombinuar analizën e përmbajtjes dhe studimin e literaturës. Rezultatet e analizës së literaturës tregojnë se IA ofron potencial të konsiderueshëm për të përmirësuar cilësinë dhe gjithëpërfshirjen arsimore, por përfitimet kanë efikasitet dhe efektivitet vetëm atëherë kur teknologjia integrohet në mënyrë të balancuar me parimet pedagogjike. Gjetjet po ashtu tregojnë se përdorimi i IA mund të mbështesë planifikimin e mësimdhënësve,

Abstract

Digital transformation and Artificial Intelligence (AI) are profoundly reshaping global and regional education systems, creating new opportunities for the professional development of teachers. This study aims to analyze the role of digital tools and AI in personalizing learning, developing digital skills, and enhancing teaching practices. The key questions addressed are: To what extent are digital tools and AI integrated into teaching? What are their pedagogical benefits and risks? How does the urban-rural context influence access to technology? The study employs an analytical and descriptive approach, combining content analysis with a review of the literature. The results of the literature review indicate that AI offers significant potential for enhancing educational quality and inclusivity; however, its benefits in terms of efficiency and effectiveness are realized only when the technology is integrated in a balanced manner with pedagogical principles. The findings further suggest that the use of AI can support teachers in lesson planning, the development of instructional

hartimin e materialeve didaktike, vlerësimin e nxënësve dhe zhvillimin e kompetencave profesionale e digjitale të mësimdhënësve. Studimi gjithashtu identifikon sfida strukturore si: infrastruktura e pamjaftueshme, hendeku digjital urban-rural, mungesa e trajnimeve, mbështetja institucionale, si dhe rreziqet si dobësimi i mendimit kritik, plagjiatura dhe varësia kognitive. Studimi konkludon se IA nuk duhet parë si zëvendësim i mësuesit, por si mjet fuqizues, mbështetës në zhvillimin e tij profesional. Integrimi i tij në mënyrë efektive kërkon strategji të qarta pedagogjike, mbështetje profesionale, zhvillim të aftësive njerëzore dhe mekanizma kontrolli, me qëllim të përdorimit në avantazhe dhe minimizimin e rreziqeve.

***Fjalët çelës*:** inteligjencë artificiale, transformim, sistem arsimor, mësimdhënës, zhvillim profesional.

materials, student assessment, and the enhancement of their own professional and digital competencies. The study also identifies structural challenges—such as inadequate infrastructure, the urban-rural digital divide, and a lack of training and institutional support as well as risks, including the weakening of critical thinking, plagiarism, and cognitive dependency. It concludes that AI should not be viewed as a replacement for the teacher, but rather as an empowering tool that supports their professional development. Effective integration requires clear pedagogical strategies, professional support, the development of human skills, and oversight mechanisms, all aimed at maximizing benefits while minimizing risks.

***Keywords*:** artificial intelligence, transformation, education system, teachers, professional development.

Integrimi i teknologjisë si mjet mbështetës në praktikat mësimore

Integrating technology as a supporting tool in teaching practices

Don Plakolli
Universiteti UBT / UBT University

Abstrakt

Praktikat e mësimdhënies dhe profesionalizmi i mësimdhënësve konsiderohen ndër faktorët më të rëndësishëm për sigurimin e një mësimdhënieje cilësore. Për këtë arsye, është e domosdoshme që mësimdhënësit t'u përgjigjen kërkesave që burojnë nga zhvillimet dhe ndryshimet e vazhdueshme bashkëkohore, ndër të cilat një vend të rëndësishëm zë edhe integrimi i teknologjisë në procesin mësimor. Pikërisht kjo çështje përbën fokusin kryesor të këtij studimi.

Përdorimi i teknologjisë ka transformuar mënyrën e mësimdhënies dhe, rrjedhimisht, ka ndikuar edhe në rezultatet e të nxënit. Në vitet e fundit, aplikimi i mjeteve teknologjike, si projektori, tabela interaktive (smart board), kompjuteri, interneti, tabletët dhe telefonat inteligjentë, ka sjellë ndryshime të konsiderueshme në burimet dhe format e mësimdhënies. Në këtë kontekst, qëllimi i studimit ishte që, përmes vëzhgimit të drejtpërdrejtë në klasë, të analizojë nivelin dhe mënyrat e integrimit të teknologjisë në procesin mësimor. Përveç identifikimit të shkallës së përdorimit të teknologjisë, studimi vlerëson edhe

Abstract

Teaching practices and teacher professionalism are considered among the most important factors in ensuring high-quality instruction. For this reason, it is essential that teachers respond to the demands arising from ongoing contemporary developments and changes among which the integration of technology into the teaching process holds a significant place. This very issue constitutes the primary focus of this study.

The use of technology has transformed the way of teaching and, consequently, has also influenced learning outcomes. In recent years, the application of technological tools such as projectors, interactive whiteboards (smart boards), computers, the internet, tablets, and smartphones has brought about significant changes in teaching resources and methods. In this context, the purpose of the study was to analyze the level and methods of technology integration within the teaching process through direct classroom observation. Beyond identifying the extent to which technology is used, the study also evaluates the

cilësinë pedagogjike të zbatimit të saj në praktikën mësimore.

Studimi është realizuar duke ndjekur qasjen kualitative. Të dhënat janë mbledhur përmes një instrumenti të strukturuar të vëzhgimit në klasë gjatë orëve mësimore, me qëllim identifikimin e praktikave reale të përdorimit të teknologjisë dhe ndikimit të saj në ndërveprimin mësimdhënës-nxënës, si dhe në pjesëmarrjen aktive dhe reflektimin e nxënësve gjatë procesit të të nxënit.

Mostra e studimit përfshin 15 mësimdhënës, prej të cilëve 5 nga niveli parafillor, 5 nga klasa e pestë dhe 5 nga klasa e shtatë. Përzgjedhja është bërë në mënyrë të qëllimshme, duke përfshirë orët mësimore ku teknologjia përdoret si mjet mbështetës i nxënies dhe jo si zëvendësim i rolit të mësimdhënësit. Analiza është fokusuar në praktikat konkrete të përdorimit të mjeteve teknologjike dhe efektivitetin e tyre në mësimdhënie.

Rezultatet e studimit tregojnë se teknologjia përdoret kryesisht për prezantimin dhe konkretizimin e përmbajtjeve mësimore. Megjithatë, integrimi i saj në funksion të qëllimeve pedagogjike ende mbetet sfidë, ndërsa niveli i zbatimit efektiv rezulton relativisht i ulët, veçanërisht te mësimdhënësit me përvojë më të gjatë profesionale. Gjetjet tregojnë gjithashtu se përdorimi i strukturuar dhe pedagogjikisht i arsyetuar i teknologjisë ndikon pozitivisht në

pedagogical quality of its implementation in teaching practice.

The study was conducted using a qualitative approach. Data were collected through a structured classroom observation instrument during lessons, with the aim of identifying actual practices regarding the use of technology and its impact on teacher-student interaction, as well as on students' active participation and reflection during the learning process.

The study sample consists of 15 teachers: 5 from the pre-primary level, 5 from the fifth grade, and 5 from the seventh grade. The selection was purposive, focusing on lessons where technology is used as a tool to support learning rather than as a replacement for the teacher's role. The analysis focuses on specific practices regarding the use of technological tools and their effectiveness in teaching.

The study results indicate that technology is primarily used for presenting and concretizing learning content. However, its integration in support of pedagogical goals remains a challenge, and the level of effective implementation is relatively low—particularly among teachers with more extensive professional experience. The findings also show that a structured and pedagogically sound use of technology positively influences the reinforcement of knowledge, boosts

përforcimin e njohurive, rrit motivimin e nxënësve dhe mundëson përfshirje më aktive të tyre në procesin mësimor.

Fjalët çelës: teknologjia në arsim, integrimi i teknologjisë, praktikat mësimore, vëzhgimi në klasë, motivimi i nxënësve, mësimdhënia efektive.

student motivation, and enables more active student engagement in the learning process.

***Keywords*:** technology in education, technology integration, instructional practices, classroom observation, student motivation, effective teaching.

Rëndësia e integrimit të teknologjisë në zhvillimin e të nxënit në fëmijërinë e hershme

The importance of integrating technology in developing of learning during early childhood education

Edona Jashari
E-mail edonajashari29@gmail.com

Erza Muqaj
E-mail erzamuqajj@gmail.com

Abstrakt

Ky hulumtim trajton ndikimin dhe rëndësinë e integrimit të teknologjisë si mjet transformues në proceset e të nxënit gjatë fëmijërisë së hershme. Qëllimi kryesor i këtij studimi është të identifikojë dhe analizojë përparësitë dhe sfidat e integrimit të teknologjisë në fëmijërinë e hershme sipas perspektivës së edukatoreve në institucione publike dhe private. Për realizimin e këtij hulumtimi është përdorur metoda e kombinuar (kuantitative dhe kualitative). Mostra e hulumtimit ishte e qëllimshme dhe përfshiu 26 edukatore të institucioneve publike dhe private të edukimit në fëmijërinë e hershme, ndërsa për pjesën cilësore janë përzgjedhur 6 edukatore të Komunës së Prishtinës, si qendër e zhvillimit të politikave dhe reformave arsimore në Kosovë. Mbledhja e të dhënave është realizuar përmes pyetësorëve dhe intervistave gjysmë të strukturuara. Të dhënat cilësore janë analizuar përmes analizës tematike, ndërsa të dhënat sasiore janë analizuar me programin statistikor SPSS (statistika përshkruese). Rezultatet e hulumtimit tregojnë se

Abstract

This research addresses the impact and significance of integrating technology as a transformative tool within early childhood learning processes. The primary objective of this study is to identify and analyze the advantages and challenges of integrating technology in early childhood education, from the perspective of educators in both public and private institutions. A mixed-methods approach (quantitative and qualitative) was employed for this research. A purposive sampling method was used, involving 26 educators from public and private early childhood education institutions; for the qualitative component, 6 educators were selected from the Municipality of Pristina a hub for the development of educational policies and reforms in Kosovo. Data collection was carried out through questionnaires and semi-structured interviews. Qualitative data were analyzed using thematic analysis, while quantitative data were analyzed using the statistical software SPSS (descriptive statistics). The research findings indicate that

pjesëmarrësit në hulumtim vlerësuan se integrimi i teknologjisë në fëmijërinë e hershme mund të mbështesë zhvillimin e kreativitetit, mendimit kritik të fëmijëve, dhe veçohet zhvillimi i aftësive gjuhësore (50%). Njëkohësisht, 69,2% e edukatoreve u pajtuan plotësisht se mbikëqyrja e përshtatshme gjatë përdorimit të teknologjisë nga fëmijët është e pamjaftueshme. Mesataret aritmetike variojnë nga M=2.58 deri në M=3.58, ndërsa devijimi standard nga DS=0.76 deri në DS=1.03, duke reflektuar nivele të ndryshme të qëndrimeve dhe të shpërndarjes së përgjigjeve. Rekomandohet hartimi i udhëzuesve të qartë institucionalë për zbatimin efektiv të teknologjisë në fëmijërinë e hershme dhe trajnimi i edukatoreve në këtë fushë, me qëllim të mbështetjes së përdorimit pedagogjikisht të përshtatshëm të teknologjisë në fëmijërinë e hershme.

Fjalët çelës: teknologjia, fëmijëria e hershme, zhvillimi i të nxënit, sfidat, trajnimi i edukatoreve.

participants believe the integration of technology in early childhood can support the development of children's creativity and critical thinking, with the development of language skills being particularly highlighted (50%). At the same time, 69.2% of educators fully agreed that the level of supervision provided while children use technology is insufficient. Arithmetic means range from M=2.58 to M=3.58, while standard deviations range from SD=0.76 to SD=1.03, reflecting varying levels of attitudes and response distribution. It is recommended to develop clear institutional guidelines for the effective implementation of technology in early childhood, and to provide training for educators in this area, with the aim of supporting the pedagogically appropriate use of technology in early childhood.

***Keywords*:** technology, early childhood, develop learning, challenges, training of educators.

Inteligjenca Artificiale dhe zhvillimi akademik i studentëve në arsimin e lartë

Artificial Intelligence and the academic development of students in higher education

Edona Jashari
E-mail: edona.jashari3@student.uni-pr.edu,

Leonora Bajrami
E-mail: leonora.bajrami@uni-pr.edu

Abstrakt

Ky studim analizon rolin dhe ndikimin e Inteligjencës Artificiale (IA) në zhvillimin akademik të studentëve në institucionet e arsimit të lartë, duke u fokusuar në mënyrën se si studentët e përdorin këtë teknologji në procesin e të nxënit, kërkimit akademik dhe përgatitjes së punimeve universitare. Studimi përdor qasje cilësore, bazuar në intervista gjysmë të strukturuara me 22 studentë të vitit të parë të studimeve bachelor në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin Filozofik, nga Departamentet e Punës Sociale, Sociologjisë dhe Shkencave Politike. Përzgjedhja e pjesëmarrësve është bërë duke u fokusuar se ky studim zbatoi qasjen cilësore me një dizajn eksplorues-përshkrues dhe nuk synon përgjithësimin e rezultateve, por ofrimin e një kuptimi më të thelluar të përvojave të studentëve në fazën fillestare të formimit akademik lidhur me përdorimin e inteligjencës artificiale. Analiza e të dhënave u realizua përmes analizës tematike për të identifikuar temat dhe kodet kryesore të përvojave të studentëve. Për të rritur besueshmërinë e

Abstract

This study analyzes the role and impact of Artificial Intelligence (AI) on the academic development of students in higher education institutions, focusing on how students utilize this technology in the learning process, academic research, and the preparation of university assignments. The study employs a qualitative approach, based on semi-structured interviews with 22 first-year bachelor's degree students at the University of Pristina's Faculty of Philosophy specifically from the Departments of Social Work, Sociology, and Political Science. The selection of participants reflects the study's qualitative, exploratory-descriptive design; it does not aim to generalize the findings, but rather to provide a deeper understanding of students' experiences with the use of artificial intelligence during the initial stage of their academic development. Data analysis was conducted using thematic analysis to identify key themes and codes related to students' experiences. To enhance the reliability of the analysis, the coding process was carried out

analizës, procesi i kodimit është realizuar në mënyrë sistematike, duke krahasuar vazhdimisht kodet dhe temat me të dhënat origjinale dhe duke përdorur citime të drejtpërdrejta. Gjetjet tregojnë se inteligjenca artificiale është integruar në praktikat e përditshme akademike të studentëve, veçanërisht për kërkimin e informacionit, përmbledhjen e materialeve, përmirësimin e shkrimit akademik dhe optimizimin e kohës. Megjithatë, rezultatet evidentojnë disa sfida, përfshirë besueshmërinë e informacionit, krijimin e varësisë nga teknologjia dhe ndikimin potencial në dobësimin e aftësive analitike dhe mendimit kritik. Kontributi i këtij studimi qëndron në evidentimin e nevojës për një qasje të balancuar ndërmjet inovacionit teknologjik dhe ruajtjes së standardeve akademike. Studimi rekomandon që institucionet e arsimit të lartë të zhvillojnë udhëzime të qarta për përdorimin etik dhe pedagogjik të IA-së, të përfshijnë aftësimin digjital të studentëve dhe stafit akademik, si dhe të hartojnë politika që promovojnë përdorimin kritik dhe të përgjegjshëm të teknologjive të inteligjencës artificiale.

Fjalët çelës: arsimi i lartë, inteligjenca artificiale, zhvillimi akademik, integriteti akademik.

systematically, involving continuous comparison of codes and themes against the original data, alongside the use of direct quotations. The findings indicate that artificial intelligence has been integrated into students' daily academic practices specifically for information seeking, summarizing materials, improving academic writing, and optimizing time. However, the results highlight several challenges, including concerns regarding the reliability of information, the development of a dependency on technology, and the potential for a weakening of analytical skills and critical thinking. The contribution of this study lies in highlighting the need for a balanced approach between technological innovation and the preservation of academic standards. The study recommends that higher education institutions develop clear guidelines for the ethical and pedagogical use of AI, incorporate digital literacy training for students and academic staff, and formulate policies that promote the critical and responsible use of artificial intelligence technologies.

Keywords: higher education, artificial intelligence, academic development, academic integrity

Roli i mësimdhënësve në menaxhimin e tranzicionit ndërmjet cikleve shkollore: sfidat e nxënësve dhe praktikat pedagogjike në kontekstin kosovar

The role of teachers in managing the transition between school cycles: students' challenges and pedagogical practices in the Kosovan context

Ermira Kajtazi Krasniqi
ShFMU "Mihal Grameno" Aneksi I, Fushë-Kosovë
"Mihal Grameno" Primary and Lower Secondary School, Annex I, Fushë-Kosovë
E-mail: ekajtazi4@gmail.com

Abstrakt

Tranzicioni ndërmjet cikleve shkollore përfaqëson një periudhë kritike në zhvillimin akademik, social dhe emocional të nxënësve. Në këtë proces kompleks, roli i mësimdhënësve është thelbësor në lehtësimin e përshtatjes së nxënësve dhe në sigurimin e vazhdimësisë pedagogjike.

Ky studim synon të analizojë rolin e mësimdhënësve në menaxhimin e tranzicionit ndërmjet cikleve shkollore në kontekstin e Kosovës, me fokus në praktikat pedagogjike, perceptimet profesionale dhe sfidat me të cilat përballen. Hulumtimi shqyrton gjithashtu bashkëpunimin ndërmjet mësimdhënësve të cikleve dhe mbështetjen institucionale në këtë proces.

Metodologjia e kombinuar përfshiu të dhëna kuantitative, të mbledhura përmes pyetësorëve me 120 mësimdhënës dhe 180 nxënës nga gjashtë komuna të Kosovës, si dhe të dhëna cilësore, të mbledhura përmes tryezave të diskutimit me mësimdhënës, drejtues shkollash, prindër,

Abstract

The transition between school cycles represents a critical period in students' academic, social, and emotional development. In this complex process, the role of teachers is essential in facilitating students' adjustment and ensuring pedagogical continuity.

This study aims to analyze the role of teachers in managing the transition between school cycles within the context of Kosovo, focusing on pedagogical practices, professional perceptions, and the challenges they face. The research also examines collaboration among teachers across different school cycles, as well as the institutional support provided during this process.

The mixed-methods approach incorporated quantitative data, collected through questionnaires administered to 120 teachers and 180 students from six municipalities in Kosovo, as well as qualitative data, gathered through roundtable discussions with teachers, school principals,

koordinatorë të cilësisë dhe përfaqësues të institucioneve arsimore.

Rezultatet tregojnë se shumica e nxënësve e përjetojnë tranzicionin në mënyrë mesatare, ndërsa sfidat kryesore lidhen me përshtatjen ndaj rregullave të reja, rënien në performancë dhe mungesën e përqendrimit. Mësimdhënësit raportojnë përdorim të praktikave mbështetëse, por një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk kanë trajnim zyrtar dhe mbështeten kryesisht në përvojën personale, në mungesë të mbështetjes institucionale. Mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve të cikleve të ndryshme del si faktor kryesor që ndikon drejtpërdrejt në menaxhimin e tranzicionit të nxënësve.

Ky hulumtim thekson nevojën për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet cikleve, rritjen e mbështetjes institucionale dhe organizimin e trajnimeve adekuate për mësimdhënësit, me qëllim përmirësimin e menaxhimit të tranzicionit në arsimin parauniversitar në Kosovë.

***Fjalët çelës*:** tranzicioni shkollor, roli i mësimdhënësve, praktikat pedagogjike, bashkëpunimi ndërmjet cikleve, mbështetja institucionale.

parents, quality coordinators, and representatives of educational institutions.

The results indicate that most students experience the transition to a moderate degree, with the primary challenges relating to adapting to new rules, a decline in academic performance, and a lack of concentration. Teachers report employing supportive practices; however, a significant number of them lack formal training and rely primarily on their personal experience, given the absence of institutional support. A lack of coordination and cooperation among teachers across different educational stages emerges as a key factor that directly impacts the management of students' transitions.

This research highlights the need to strengthen cooperation between educational stages, increase institutional support, and organize appropriate training for teachers, with the aim of improving the management of transitions within pre-university education in Kosovo.

Keywords: school transition, role of teachers, pedagogical practices, collaboration between educational stages, institutional support.

Sfidat më të shpeshta me të cilat përballen mësimdhënësit në shkollat fillore

Frequent challenges faced by teachers in primary schools

Fatlindë Latifi
ShFMU “Sadri Misini”, Shipashnicë – Kamenicë
“Sadri Misini” Primary and Lower Secondary School, Shipashnicë – Kamenicë
E-mail: fatlinda038@gmail.com

Abstrakt

Ky hulumtim, me titull *Sfidat me të cilat përballen mësimdhënësit në shkollat fillore*, synon të identifikojë dhe të analizojë sfidat më të shpeshta, me të cilat përballen mësuesit në rolin e tyre profesional. Hulumtimi trajton ndikimin e këtyre sfidave në mësimdhënien efektive dhe në rezultatet e të nxënit.

Përmes rishikimit të literaturës dhe metodologjisë sasiore të kërkimit, janë identifikuar disa sfida kryesore, si: përfshirja e nxënësve, menaxhimi i klasës, diversiteti i nxënësve, kërkesat e kurrikulës, ngarkesa në punë dhe mirëqenia profesionale e mësuesve.

Hulumtimi është realizuar me qasje sasiore, duke përdorur pyetësorin si instrument të mbledhjes së të dhënave. Në studim kanë marrë pjesë 50 mësimdhënës të arsimit fillor nga dy shkolla publike në komunën e Gjilanit, ndërsa të dhënat janë analizuar përmes statistikës përshkruese, duke përdorur përqindjet e përgjigjeve të pjesëmarrësve.

Rezultatet tregojnë se mësimdhënësit përballen vazhdimisht me probleme të ndryshme, të cilat

Abstract

This research, titled *"Challenges Faced by Teachers in Primary Schools,"* aims to identify and analyze the most frequent challenges that teachers encounter in their professional roles. The study examines the impact of these challenges on effective teaching and learning outcomes.

Through a literature review and quantitative research methodology, several key challenges have been identified, such as: student engagement, classroom management, student diversity, curriculum requirements, workload, and teachers' professional well-being.

The research was conducted using a quantitative approach, with a questionnaire serving as the data collection instrument. The study involved 50 primary school teachers from two public schools in the municipality of Gjilan, and the data were analyzed through descriptive statistics, utilizing the percentages of the participants' responses.

The results indicate that teachers consistently face various challenges that affect the quality of education and the effectiveness of the teaching

ndikojnë në cilësinë e arsimit dhe në efektivitetin e procesit mësimor. 40% e të anketuarve e konsiderojnë plotësimin e nevojave të ndryshme të nxënësve dhe kërkesave të kurrikulës si sfidën kryesore, ndërsa 74% vlerësojnë se këto sfida ndikojnë shumë në efektivitetin e mësimdhënies dhe të nxënies. Po ashtu, 64% e mësimdhënësve deklarojnë se sfidat ndikojnë dukshëm në mirëqenien e tyre profesionale, ndërsa 100% e pjesëmarrësve theksojnë se përdorimi i teknologjisë e lehtëson procesin mësimor.

Për këtë arsye, evidentimi i sfidave dhe gjetja e strategjive për tejkalimin e tyre paraqet një çështje të rëndësishme për sistemin arsimor. Hulumtimi thekson nevojën për mbështetje të vazhdueshme ndaj mësuesve përmes zhvillimit profesional, mentorimit, trajnimeve, dhe sigurimit të burimeve adekuate për mësimdhënie. Kontributi i këtij studimi qëndron në ofrimin e evidencave empirike mbi sfidat, me të cilat përballen mësimdhënësit e arsimit fillor në Kosovë, dhe në identifikimin e fushave që kërkojnë mbështetje institucionale për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor.

Fjalët çelës: mësimdhënësit, sfidat në arsim, strategjitë e mësimdhënies, zhvillimi profesional

and learning process. 40% of respondents identify meeting the diverse needs of students and the requirements of the curriculum as the primary challenge, while 74% believe that these challenges significantly impact the effectiveness of teaching and learning. Furthermore, 64% of teachers state that these challenges have a notable effect on their professional well-being, and 100% of participants emphasize that the use of technology facilitates the teaching and learning process.

For this reason, identifying challenges and finding strategies to overcome them is a significant issue for the education system. The research highlights the need for ongoing support for teachers through professional development, mentoring, training, and the provision of adequate teaching resources. The contribution of this study lies in providing empirical evidence regarding the challenges faced by primary education teachers in Kosovo, and in identifying areas that require institutional support to improve the quality of the teaching and learning process.

***Keywords*:** teachers, challenges in education, teaching strategies, professional development.

Eksplorimi i procesit të bashkëpunimit ndërmjet aktiveve profesionale dhe pedagogut në kontekstin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve

Exploring the collaboration process between professional activas and the school pedagogue within the context of teachers' professional development

Flakrona Gashi, Msc
E-mail: flakronagashi1@gmail.com

Majlinda Gashi, Msc
E-mail: majlindaagashi10@gmail.com
Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit / University of Pristina, Faculty of Education

Abstrakt

Bashkëpunimi ndërmjet aktiveve profesionale dhe pedagogut në shkolla përbën një komponent të rëndësishëm të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Në vendet e tjera bashkëpunimi profesional realizohet përmes komuniteteve të mësimit profesional (Professional Learning Communities – PLC), të cilat bazohen në reflektimin e përbashkët, përgjegjësinë kolektive dhe përmirësimin e vazhdueshëm të praktikës mësimore. Në kontekstin shkollor të Kosovës, aktivet profesionale përfaqësojnë një formë të organizuar të bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve, ndërsa pedagogu luan rol mbështetës në zhvillimin dhe koordinimin e aktiveve profesionale. Ky hulumtim ka synuar të eksplorojë procesin e bashkëpunimit ndërmjet aktiveve profesionale dhe pedagogut në kontekstin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe të

Abstract

Collaboration between professional activas and the school pedagogue constitutes an important component of teachers' continuous professional development and the improvement of teaching quality. In other countries, professional collaboration is realized through Professional Learning Communities (PLCs), which are based on shared reflection, collective responsibility, and the continuous improvement of instructional practice. Within the school context in Kosovo, professional activas represent an organized form of collaboration among teachers, while the pedagogue plays a supportive role in the development and coordination of these activas. This research aimed to explore the process of collaboration between professional activas and the pedagogue in the context of teachers' professional development, and to analyze the extent to which this collaboration reflects elements of a PLC.

analizojë se në çfarë mase ky bashkëpunim pasqyron elemente të PLC.

Hulumtimi është bazuar në qasje cilësore (kualitative), ndërsa modeli i hulumtimit është eksplorues, i dizajnuar si studim rasti (case study). Studimi i rastit mundëson kuptimin e praktikave, përvojave dhe sfidave që lidhen me procesin e bashkëpunimit ndërmjet aktiveve profesionale dhe pedagogut në kontekstin e zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Hulumtimi është realizuar në një shkollë të përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme. Të dhënat janë mbledhur përmes intervistave gjysmë të strukturuara me mësimdhënës dhe me pedagogen e shkollës, si dhe përmes analizës së dokumenteve relevante. Të dhënat janë analizuar përmes analizës tematike, duke identifikuar format dhe modelet e bashkëpunimit, si dhe sfidat që lidhen me funksionimin e këtij procesi.

Gjetjet e hulumtimit tregojnë se bashkëpunimi ndërmjet aktiveve profesionale dhe pedagogut mbështet zhvillimin profesional të mësimdhënësve përmes shkëmbimit të përvojave dhe materialeve mësimore. Pedagogu luan rol mbështetës dhe koordinues, ndërsa në këtë proces evidentohen elemente të PLC-së, si bashkëpunimi profesional, përgjegjësia kolektive dhe përmirësimi i vazhdueshëm i praktikës mësimore.

Fjalët çelës: bashkëpunim profesional, aktive profesionale, pedagog, zhvillim profesional.

The research is based on a qualitative approach, utilizing an exploratory research design in the form of a case study. This case study facilitates an understanding of the practices, experiences, and challenges associated with the collaboration between professional activas and the school pedagogue within the context of teachers' professional development. The research was conducted in a school selected through purposive sampling. Data were collected via semi-structured interviews with teachers and the school pedagogue, as well as through the analysis of relevant documents. The data were examined using thematic analysis, identifying the forms and patterns of collaboration, along with the challenges related to the functioning of this process.

Research findings indicate that collaboration between professional activas and the school pedagogue supports teachers' professional development through the exchange of experiences and instructional materials. The pedagogue plays a supportive and coordinating role, while the process incorporates elements of a Professional Learning Community (PLC) such as professional collaboration, collective responsibility, and the continuous improvement of teaching practice.

***Keywords*:** professional collaboration, professional activas, pedagogue, professional development.

Roli i institucioneve qendrore dhe lokale në zhvillimin e politikave për ZhPM - Licencim

The Role of Central and Local Institutions in Developing Teacher Professional Development Policies: Licensing

Ardita Rexhepi MA
Universiteti i Prishtinës – Këshillim Pedagogjik;

Hatixhe Gashi
Mësimdhënëse në shkollën Model "Qamil Batalli", Prishtinë;

Rina Shabani
Mësimdhënëse në shkollën "Princenton School of Prishtina";

Vera Hajdini
Mësimdhënëse në shkollën "Xhemail Mustafa", Prishtinë.

Abstrakt

Ky hulumtim shqyrton rolin e MASh-it në hartimin e politikave për licencim dhe Zhvillim Profesional të Mësimdhënësve (ZhPM), si dhe mbështetjen për zbatimin e tyre në nivel shkolle. Analiza fokusohet në Kornizën Strategjike dhe Udhëzimet Administrative nr. 12/14/16/2023, duke theksuar edhe rolin e Drejtorive Komunale të Arsimit (DKA) në koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave në nivel lokal. Qëllimi i hulumtimit është të identifikojë sfidat praktike gjatë implementimit dhe të vlerësojë efektivitetin e bashkëpunimit institucional.

Hulumtimi bazohet në një qasje cilësore, e cila synon të kuptojë përvojat dhe perceptimet e aktorëve të përfshirë në këtë proces. Përzgjedhja e pjesëmarrësve është e qëllimshme dhe përfshin një zyrtar nga MASh-i, tre zyrtarë të DKA-ve dhe

Abstract

This study examines the role of the Ministry of Education and Science in formulating policies on teacher licensing and teacher professional development, as well as the support provided for their implementation at school level. The analysis focuses on the Strategic Framework and Administrative Instructions Nos. 12, 14 and 16/2023, while also highlighting the role of Municipal Education Directorates in coordinating and monitoring policy implementation at local level. The study aims to identify practical challenges arising during implementation and assess the effectiveness of institutional cooperation.

The study adopts a qualitative approach to explore the experiences and perceptions of stakeholders involved in this process. Purposive sampling was used to select one official from the Ministry of

tre drejtorë shkollash. Të dhënat janë mbledhur përmes intervistave gjysmë të strukturuara dhe janë analizuar duke përdorur analizën tematike, me fokus në identifikimin e temave dhe modeleve të përsëritura.

Rezultatet preliminare tregojnë se, pavarësisht ekzistencës së një kornize të strukturuar mirë dhe mbështetjes institucionale, shkollat dhe mësimdhënësit përballen me sfida në zbatim. Këto përfshijnë mungesën e burimeve financiare, vështirësi në përshtatjen e trajnimeve me nevojat reale dhe mungesë të koordinimit efektiv ndërmjet MASH-it, DKA-ve dhe shkollave. Hulumtimi kontribuon në identifikimin e boshllëqeve në implementim dhe ofron implikime për përmirësimin e politikave arsimore dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve në Kosovë.

Fjalët çelës: DKA, licencim, MASh, ZhPM.

Education and Science, three officials from Municipal Education Directorates and three school principals. Data were collected through semi-structured interviews and analysed thematically to identify recurring themes and patterns.

Preliminary findings suggest that, despite a well-structured framework and institutional support, schools and teachers face implementation challenges. These include insufficient financial resources, difficulties in aligning training with actual needs, and a lack of effective coordination between the Ministry of Education and Science, Municipal Education Directorates and schools. The study identifies gaps in implementation and offers implications for improving education policy and teacher professional development in Kosovo.

Keywords**:** teacher licensing; teacher professional development; education policy; municipal education directorates; institutional cooperation.

Inteligjenca Artificiale në mësimdhënien e gjuhës angleze: mundësitë dhe sfidat për zhvillimin profesional të mësimdhënësve

Artificial Intelligence in English Language Teaching: Opportunities and Challenges for Teachers' Professional Development

MSc. Kaltrina Ramadani
Universiteti i Evropës Juglindore, Tetovë - Maqedoni e Veriut
E- mail: kaltrinaramadani09@gmail.com

Edi Ramadani
Kolegji UBT, Prishtinë
E- mail: ediramadani09@gmail.com

Abstrakt

Inteligjenca Artificiale (IA) po e transformon arsimin modern, veçanërisht në fushën e mësimdhënies së gjuhës angleze (ELT). Mjetet e IA-së, si ChatGPT, aplikacionet e mësimit të gjuhëve dhe platformat virtuale të të nxënit, po i ndihmojnë mësuesit të përmirësojnë praktikat në klasë dhe të mbështesin nxënësit në mënyrë më efektive. Ky punim shqyrton mundësitë dhe sfidat e përdorimit të IA-së në zhvillimin profesional të mësuesve.

Metodologjia e aplikuar në këtë punim bazohet në një rishikim sistematik të literaturës shkencore të periudhës së fundit. Burimet e të dhënave janë siguruar përmes indeksimit në platformat akademike si Google Scholar dhe Scopus, duke përzgjedhur artikuj shkencorë të rishikuar nga kolegët (peer-reviewed) sipas dy kritereve kryesore: ndikimi i IA-së në mësimdhënien e gjuhës angleze (ELT) dhe modelet e zhvillimit profesional të edukatorëve. Të dhënat e grumbulluara iu nënshtruan një analize tematike

Abstract

Artificial intelligence is transforming contemporary education, particularly English language teaching. Artificial intelligence tools, including ChatGPT, language-learning applications and virtual learning platforms, help teachers improve classroom practices and support learners more effectively. This paper examines the opportunities and challenges associated with the use of artificial intelligence in teachers' professional development.

The methodology is based on a systematic review of recent scientific literature. Sources were identified through academic platforms, including Google Scholar and Scopus. Peer-reviewed research articles were selected according to two principal criteria: the impact of artificial intelligence on English language teaching and models of educators' professional development. The collected material was subjected to qualitative thematic analysis to identify current trends.

cilësore për të identifikuar tendencat aktuale.

Gjetjet konkrete të këtij studimi tregojnë se integrimi i IA-së optimizon kohën e planifikimit mësimor përmes gjenerimit të automatizuar të materialeve të diferencuara dhe mundëson krijimin e planeve të personalizuara për nivele të ndryshme të zotërimit të gjuhës. Sidoqoftë, rezultatet nxjerrin në pah se sfidat kryesore nuk janë thjesht teknologjike, por lidhen me mungesën e kornizave trajnuese institucionale për mësuesit, rreziqet e cenimit të privatësisë së të dhënave të nxënësve dhe vështirësitë në ruajtjen e integritetit akademik gjatë vlerësimit. Duke përdorur një perspektivë ndërdisiplinore, që kombinon arsimin e gjuhës angleze dhe shkencat kompjuterike, ky punim thekson rëndësinë e përgatitjes së mësuesve për mjediset e të nxënit në fushën e IA-së. Studimi arrin në përfundimin se integrimi i suksesshëm i IA-së në ELT kërkon zhvillim të vazhdueshëm profesional, shkrim-lexim digjital dhe përdorim të përgjegjshëm të teknologjisë në arsim.

Fjalët çelës: Inteligjenca Artificiale, zhvillim profesional, mësim i gjuhës së dytë, digjitalizim, arsim.

The findings indicate that integrating artificial intelligence can reduce lesson-planning time through the automated generation of differentiated materials and enable personalised plans for learners with different levels of language proficiency. However, the principal challenges are not merely technological: they include the absence of institutional teacher-training frameworks, risks to the privacy of pupils' data and difficulties in maintaining academic integrity in assessment. Adopting an interdisciplinary perspective that combines English language education and computer science, the paper highlights the importance of preparing teachers for artificial intelligence-supported learning environments. It concludes that successful integration requires continuous professional development, digital literacy and responsible use of technology in education.

Keywords**:** artificial intelligence; professional development; second-language learning; digitalisation; education.

Tiparet e personalitetit dhe vetefikasiteti i mësimdhënësve në Kosovë: Implikime për motivimin profesional

Personality Traits and Teacher Self-Efficacy in Kosovo: Implications for Professional Motivation

Lirie Lokaj, PhD
E-mail: Lokaj.lirie@gmail.com

Abstrakt

Ky studim shqyrton lidhjen midis tipareve të personalitetit dhe vetefikasitetit të mësimdhënësve në Kosovë, si dhe ndikimin e faktorëve kulturorë dhe socialë në këtë marrëdhënie. Për këtë qëllim, u përdor një qasje hulumtuese të kombinuar, sasiore dhe cilësore, duke përfshirë në mostër 350 mësimdhënës të arsimit të mesëm të ulët. Rezultatet tregojnë një korrelacion pozitiv midis vetefikasitetit dhe tipareve të *Ekstraversionit, Hapjes ndaj përvojës, Pajtueshmërisë dhe Ndërgjegjshmërisë, por Ndërgjegjshmëria* rezultoi të ishte domeni parashikues më i fuqishëm. *Neuroticizmi* nuk tregoi një ndikim të rëndësishëm, edhe pse rezultoi të jetë negativisht i lidhur me vetefikasitetin. Po ashtu, mësimdhënësit e fushave STEM raportuan nivele më të larta të vetefikasitetit sesa ata të shkencave shoqërore. Analiza e regresionit linear tregoi se Ekstraversioni dhe Ndërgjegjshmëria ishin domenet parashikuese kryesore të vetefikasitetit, me Ekstraversionin që parashikonte një rritje të vetefikasitetit me 2.4 herë për çdo njësi të shtuar.

Në kontekstin e motivimit profesional, këto rezultate sugjerojnë se vetefikasiteti dhe tiparet e personalitetit mund të ndihmojnë në ruajtjen e

Abstract

This study examines the relationship between personality traits and teacher self-efficacy in Kosovo, as well as the influence of cultural and social factors on that relationship. A mixed-methods approach combining quantitative and qualitative research was employed with a sample of 350 lower-secondary teachers. The results show positive correlations between self-efficacy and extraversion, openness to experience, agreeableness and conscientiousness, with conscientiousness emerging as the strongest predictor. Neuroticism was negatively associated with self-efficacy but did not show a significant effect. Teachers of science, technology, engineering and mathematics subjects also reported higher self-efficacy than teachers of social sciences. Linear regression identified extraversion and conscientiousness as the main predictors of self-efficacy; the Albanian source reports that each one-unit increase in extraversion predicts a 2.4-fold increase in self-efficacy.

In the context of professional motivation, these findings suggest that self-efficacy and personality traits may help sustain teachers' motivation

motivimit të mësimdhënësve përgjatë karrierës, ndërsa burimet e motivimit ndryshojnë me kalimin e kohës. Studimi sugjeron që programet e trajnimit të përqendrohen në zhvillimin e tipareve të personalitetit, forcimin e aftësive organizative dhe sociale dhe rritjen e vetefikasitetit të mësimdhënësve. Studimi përfaqëson një kontribut të rëndësishëm në literaturën ekzistuese dhe sugjeron nevojën për hulumtime të mëtejshme mbi faktorët që ndikojnë në vetefikasitetin e mësimdhënësve në kontekste të ndryshme arsimore.

Fjalët kyçe: vetëefikasiteti i mësimdhënësve; tiparet e personalitetit; motivimi profesional; ndërgjegjshmëria; ekstraversioni

throughout their careers, even as the sources of motivation change over time. The study recommends that training programmes focus on developing personality traits, strengthening organisational and social skills, and enhancing teacher self-efficacy. It contributes to the existing literature and highlights the need for further research into factors influencing teacher self-efficacy in different educational contexts.

***Keywords*:** teacher self-efficacy; personality traits; professional motivation; conscientiousness; extraversion.

Përvoja e nxënësve që dëgjojnë me prindër të shurdhër në Kosovë

The Experiences of Hearing Students with Deaf Parents in Kosovo

Luljeta Behluli Kabashi
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Albulena Rrustemi Vejsa
Qendra Burimore për mësim dhe këshillim "Nënë Tereza", Prizren

Abstrakt

Nxënësit që dëgjojnë dhe kanë prindër të shurdhër ndodhen në një pozitë unike ndërmjet komunitetit të personave të shurdhër dhe atij të personave që dëgjojnë. Ata shpesh marrin rolin e ndërmjetësuesit gjuhësor dhe komunikues për prindërit e tyre në situata të ndryshme familjare, arsimore dhe shoqërore. Duke u mbështetur në studimet që trajtojnë ndërmjetësimin gjuhësor dhe fenomenin e parentifikimit (marrjes së përgjegjësive të të rriturve nga fëmijët), ky studim synon të eksplorojë përvojat e nxënësve që dëgjojnë me prindër të shurdhër në Kosovë.

Studimi është realizuar përmes një qasjeje cilësore. Të dhënat janë mbledhur përmes intervistave gjysmë të strukturuara me 12 nxënës, të përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme, bazuar në kriterin që të dy prindërit të jenë persona të shurdhër. Të dhënat janë analizuar përmes analizës tematike, duke identifikuar modelet dhe temat kryesore që përshkruajnë përvojat e pjesëmarrësve.

Analiza nxori në pah dy tema kryesore: (1) përballja me stigmatizimin dhe paragjykimet që

Abstract

Hearing students with deaf parents occupy a distinctive position between the Deaf community and the hearing community. They often act as linguistic and communication intermediaries for their parents in family, educational and social situations. Drawing on research on language brokering and parentification (children assuming adult responsibilities), this study explores the experiences of hearing students with deaf parents in Kosovo.

The study used a qualitative approach. Data were collected through semi-structured interviews with 12 students purposively selected on the criterion that both parents were deaf. The data were analysed thematically to identify key patterns and themes in participants' experiences.

Two main themes emerged: (1) experiences of stigma and prejudice associated with having deaf parents; and (2) the role of language broker in communication between parents and the hearing community. Participants assumed substantial

lidhen me të qenit fëmijë i prindërve të shurdhër dhe (2) roli i ndërmjetësit gjuhësor në komunikimin ndërmjet prindërve dhe komunitetit që dëgjon. Gjetjet tregojnë se pjesëmarrësit marrin përgjegjësi të konsiderueshme komunikimi që në moshë të hershme, gjë që ndikon në përvojat e tyre sociale dhe shkollore. Njëkohësisht, ata zhvillojnë kompetenca të avancuara ndërpersonale dhe aftësi të veçanta komunikimi.

Studimi thekson nevojën që shkollat, mësimdhënësit dhe shërbimet profesionale mbështetëse, si psikologët, pedagogët dhe mësuesit mbështetës, të kenë një kuptim më të thellë të sfidave dhe përgjegjësive me të cilat përballen këta nxënës. Një mbështetje më e informuar dhe më e ndjeshme ndaj nevojave të tyre mund të përmirësojë bashkëpunimin shkollë–familje dhe të lehtësojë përfshirjen e prindërve të shurdhër në procesin arsimor të fëmijëve të tyre.

***Fjalët çelës*:** nxënësit që dëgjojnë, prindërit e shurdhër, ndërmjetësimi gjuhësor.

communication responsibilities from an early age, affecting their social and school experiences. At the same time, they developed advanced interpersonal competencies and distinctive communication skills.

The study emphasises the need for schools, teachers and professional support services, including psychologists, pedagogues and support teachers, to understand these students' challenges and responsibilities more fully. Better-informed, needs-sensitive support could strengthen school–family cooperation and facilitate deaf parents' involvement in their children's education.

***Keywords*:** hearing students; deaf parents; language brokering.

Sfidat e mësimdhënësve të gjuhës shqipe në përballje me ndikimet globale dhe mediat digjitale

Challenges Facing Albanian Language Teachers in Responding to Global Influences and Digital Media

Dr. Migena Arllati
Ligjëruese në Universitetin e Gjakovës "Fehmi Agani"
E-mail: migena.arllati@uni-gjk.org, marllati@gmail.com

Abstrakt

Globalizimi dhe zhvillimi i teknologjisë digjitale kanë sjellë ndryshime të rëndësishme në përdorimin e gjuhës shqipe, duke ndikuar drejtpërdrejt në komunikimin dhe shprehitë gjuhësore të brezave të rinj. Në këtë kontekst, mësimdhënësit e gjuhës shqipe përballen me sfida të reja në ruajtjen dhe kultivimin e normës standarde, si dhe në zhvillimin e kompetencës gjuhësore të nxënësve.

Qëllimi i këtij punimi është të analizojë ndikimin e proceseve globale dhe të mediave digjitale në përdorimin e gjuhës shqipe dhe të identifikojë sfidat kryesore me të cilat përballen mësimdhënësit në praktikën e tyre profesionale. Studimi mbështetet në analizën e literaturës bashkëkohore shkencore dhe pedagogjike, si dhe në shqyrtimin e fenomeneve gjuhësore që manifestohen në komunikimin digjital dhe në mjedisin shkollor.

Gjetjet tregojnë se përdorimi i shpeshtë i anglicizmave, gjuha hibride në rrjetet sociale, komunikimi i shpejtë digjital dhe rënia e kulturës së

Abstract

Globalisation and the development of digital technology have brought significant changes to the use of the Albanian language, directly influencing communication and the linguistic practices of younger generations. In this context, Albanian language teachers face new challenges in preserving and cultivating the standard language and developing pupils' linguistic competence.

This paper aims to analyse the impact of global processes and digital media on Albanian language use and to identify the principal challenges teachers encounter in professional practice. The study draws on an analysis of contemporary scientific and pedagogical literature and an examination of linguistic phenomena evident in digital communication and school settings.

The findings indicate that frequent use of Anglicisms, hybrid language on social media, rapid digital communication and declining reading habits contribute to a reduction in pupils' active vocabulary, increased spelling errors and weaker

leximit ndikojnë në varfërimin e fjalorit aktiv të nxënësve, në shtimin e gabimeve drejtshkrimore dhe në dobësimin e përdorimit të normës standarde. Po ashtu, evidentohet se mungesa e politikave të koordinuara institucionale për promovimin e kulturës gjuhësore e vështirëson përballimin e këtyre sfidave në sistemin arsimor.

Punimi arrin në përfundimin se, megjithëse globalizimi dhe mediat digjitale paraqesin sfida të konsiderueshme për gjuhën shqipe, ato nuk përbëjnë domosdoshmërisht një kërcënim për ekzistencën e saj. Ruajtja dhe zhvillimi i kulturës gjuhësore kërkojnë një qasje të integruar ndërmjet institucioneve arsimore, politikave gjuhësore dhe praktikave bashkëkohore të mësimdhënies. Në këtë proces, roli i mësimdhënësit mbetet vendimtar në krijimin e ekuilibrit ndërmjet hapjes ndaj zhvillimeve globale dhe ruajtjes së identitetit gjuhësor shqiptar.

Fjalët çelës: globalizim, digjitalizim, gjuha shqipe, mësimdhënie, identitet gjuhësor, arsim. bashkëkohor.

adherence to standard-language norms. A lack of coordinated institutional policies to promote linguistic culture further complicates responses to these challenges in the education system.

The paper concludes that although globalisation and digital media present considerable challenges for Albanian, they do not necessarily threaten its continued existence. Preserving and developing linguistic culture requires an integrated approach involving educational institutions, language policies and contemporary teaching practices. Teachers remain central to balancing openness to global developments with the preservation of Albanian linguistic identity.

***Keywords*:** globalisation; digitalisation; Albanian language; language teaching; linguistic identity; contemporary education.

Vlerësimi i rezultateve të të nxënit për shkallë kurrikulare në arsimin parauniversitar

Assessing Learning Outcomes at Curriculum Stage Level in Pre-University Education

Milazim Avdylaj
mësimdhënës në shkollën "Hysen Rexhepi", Prizren

Sejdi Bellanica
mësimdhënës në shkollën "Hysen Rexhepi", Prizren

Shpëtim Kastrati
mësimdhënës në shkollën "Mileniumi i Tretë", Prishtinë

Abstrakt

Ky hulumtim në veprim trajton sfidat e vlerësimit të rezultateve të të nxënit për shkallë kurrikulare, me fokus në shkallën e tretë të Kurrikulës së Kosovës dhe në zbatimin e mësimdhënies së bazuar në kompetenca. Duke u nisur nga praktika shkollore, n të cilën vlerësimi shpesh mbetet i orientuar kryesisht në njohuri lëndore, hulumtimi synon të identifikojë një mekanizëm më funksional, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, për vlerësimin e kompetencave të nxënësve.

Përmes një procesi gjashtëvjeçar kërkimi, reflektimi dhe zbatimi në praktikë, mësimdhënësit e shkollës "Hysen Rexhepi" kanë testuar forma të ndryshme të vlerësimit, duke përfshirë teste me shkrim, qendra testimi në nivel shkolle, detyra shtëpie, projekte, aktivitete kurrikulare e jashtëkurrikulare, si dhe situata nga jeta reale, me theks të veçantë te vullnetarizmi. Gjetjet tregojnë se një instrument i vetëm dhe një metodë e vetme pune nuk mjaftojnë për të vlerësuar të gjitha

Abstract

This action research addresses the challenges of assessing learning outcomes at curriculum stage level, focusing on the third stage of the Kosovo Curriculum and the implementation of competency-based teaching. Drawing on school practice, where assessment often remains primarily oriented towards subject knowledge, the study seeks to identify a more functional, inclusive and sustainable mechanism for assessing pupils' competencies.

Over six years of research, reflection and practical implementation, teachers at Hysen Rexhepi School tested various forms of assessment, including written tests, school-based testing centres, homework, projects, curricular and extracurricular activities, and real-life situations, with particular emphasis on volunteering. The findings show that no single assessment instrument or method is sufficient to assess all

rezultatet e të nxënit për shkallë kurrikulare. Përkundrazi, nevojitet kombinimi i konteksteve të ndryshme të të nxënit dhe përshtatja e instrumenteve të vlerësimit me natyrën e kompetencave që synohen të zhvillohen dhe të maten.

Hulumtimi propozon një model vlerësimi të bazuar në katër kontekste kryesore: mësimdhënia dhe mësimnxënia në klasë; detyrat e shtëpisë, projektet dhe aktivitetet e tjera kurrikulare e jashtëkurrikulare; aktivitetet nga jeta reale e përditshme, përfshirë vullnetarizmin; si dhe qendra testuese në nivel shkolle. Ky model synon të mundësojë përfshirjen e të gjithë nxënësve dhe mësimdhënësve, mbledhjen sistematike të dëshmive për arritjet e nxënësve, si dhe certifikimin përfundimtar të tyre në përputhje me kërkesat e Kornizës Kurrikulare dhe Kurrikulës Bërthamë të Kosovës.

Fjalët çelës: hulumtim në veprim, vlerësim i kompetencave, rezultate të të nxënit, shkallë kurrikulare, Kurrikula e Kosovës, vullnetarizëm, vlerësim gjithëpërfshirës.

learning outcomes at curriculum stage level. Instead, different learning contexts must be combined, and assessment instruments adapted to the nature of the competencies being developed and measured.

The study proposes an assessment model comprising four main contexts: classroom teaching and learning; homework, projects and other curricular and extracurricular activities; everyday real-life activities, including volunteering; and school-based testing centres. The model aims to involve all pupils and teachers, enable the systematic collection of evidence of pupils' achievements, and support their final certification in accordance with the Kosovo Curriculum Framework and Core Curriculum.

***Keywords*:** action research; competency assessment; learning outcomes; curriculum stages; Kosovo Curriculum; volunteering; inclusive assessment.

Ndërlidhja mes mirëqenies profesionale, motivimit dhe zhvillimit në karrierën e mësimdhënësve

The Relationship Between Professional Well-Being, Motivation and Teachers' Career Development

Miranda Baruti[1], Mirlinda Fazliu[2], Albana Bytyqi[3]
[1.] Kolegji Heimerer, Fakulteti i Shkencave Shëndetësore Terapeutike
E-mail: miranda.baruti@kolegji-heimerer.eu

[2.3.] ShFMU "Pjetër Bogdani", Prishtinë

Abstrakt

Mirëqenia profesionale dhe motivimi konsiderohen faktorë kyç në zhvillimin e qëndrueshëm të mësimdhënësve përgjatë karrierës së tyre. Megjithatë, sfidat e vazhdueshme në mjedisin arsimor ndikojnë në nivelin e kënaqësisë në punë dhe në mundësitë për zhvillim profesional. Ky studim synon të analizojë ndërlidhjen mes mirëqenies profesionale, motivimit dhe zhvillimit në karrierën e mësimdhënësve.

Studimi është realizuar përmes një qasjeje kuantitative. Mostra përfshiu 80 mësimdhënës të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët. Të dhënat u mblodhën përmes një pyetësori të standardizuar që mat mirëqenien profesionale, motivimin dhe angazhimin në zhvillim profesional. Analiza e të dhënave u realizua përmes statistikave përshkruese dhe analizës së korrelacionit (Pearson).

Rezultatet tregojnë një lidhje pozitive dhe statistikisht domethënëse mes mirëqenies profesionale dhe motivimit (r = .52), si dhe mes motivimit dhe angazhimit në zhvillim profesional (r

Abstract

Professional well-being and motivation are regarded as key factors in teachers' sustainable development throughout their careers. However, persistent challenges in educational settings affect job satisfaction and opportunities for professional development. This study examines the relationship between professional well-being, motivation and teachers' career development.

The study employed a quantitative approach involving 80 primary and lower-secondary teachers. Data were collected through a standardised questionnaire measuring professional well-being, motivation and engagement in professional development. Descriptive statistics and Pearson correlation analysis were used.

The results show positive, statistically significant relationships between professional well-being and motivation (r = .52) and between motivation and engagement in professional development (r = .47). Professional well-being was also moderately

= .47). Gjithashtu, mirëqenia profesionale rezultoi e lidhur në mënyrë të moderuar me zhvillimin në karrierë (r = .49). Mbi 70% e mësimdhënësve raportuan se nivelet më të larta të mirëqenies ndikojnë drejtpërdrejt në gatishmërinë e tyre për zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Gjetjet sugjerojnë se mirëqenia profesionale dhe motivimi janë faktorë të ndërlidhur që ndikojnë në mënyrë të rëndësishme në zhvillimin e mësimdhënësve përgjatë karrierës. Kjo thekson nevojën për politika dhe praktika institucionale që mbështesin mirëqenien dhe rrisin motivimin, me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe zhvillimit profesional të qëndrueshëm.

Fjalët çelës: mirëqenie profesionale, motivim, zhvillim profesional, mësimdhënës, karrierë

associated with career development (r = .49). More than 70% of teachers reported that higher well-being directly influenced their willingness to undertake continuing professional development.

The findings suggest that professional well-being and motivation are interconnected factors with an important influence on teachers' career development. They highlight the need for institutional policies and practices that support well-being and enhance motivation in order to improve teaching quality and sustain professional development.

***Keywords*:** professional well-being; motivation; professional development; teachers; career development.

Zotësia (kultura) e leximit në arsimin e mesëm profesional: roli në zhvillimin e kompetencave të nxënësve dhe në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve

Reading Literacy in Vocational Secondary Education: Its Role in Developing Students' Competencies and Teachers' Continuing Professional Development

Murteza Osdautaj

Abstrakt

Zotësia e leximit përbën një nga kompetencat themelore për përgatitjen e nxënësve për tregun e punës, për zhvillimin e tyre personal dhe profesional, si dhe për të nxënit gjatë gjithë jetës. Në arsimin e mesëm profesional, rëndësia e kësaj kompetence lidhet jo vetëm me aftësinë për të lexuar dhe kuptuar tekste të përgjithshme, por edhe me interpretimin e teksteve teknike, kuptimin e udhëzimeve të punës, analizimin e dokumentacionit profesional dhe zbatimin e informacionit të shkruar në situata konkrete praktike.

Ky punim synon të analizojë rolin e zotësisë (kulturës) së leximit në zhvillimin e kompetencave të nxënësve të arsimit të mesëm profesional dhe në përmirësimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve. Në fokus të trajtimit janë ndërlidhja e kompetencave të leximit me të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve, komunikimin profesional dhe zbatimin e njohurive teorike në praktikë, si dhe rëndësia e

Abstract

Reading literacy is a fundamental competency for preparing students for the labour market, supporting their personal and professional development, and enabling lifelong learning. In vocational secondary education, it encompasses not only reading and understanding general texts but also interpreting technical texts, understanding work instructions, analysing professional documentation and applying written information in practical situations.

This paper analyses the role of reading literacy in developing vocational secondary students' competencies and improving teachers' continuing professional development. It focuses on the relationship between reading competencies and critical thinking, problem-solving, professional communication and the application of theoretical knowledge in practice. It also considers the importance of reading scientific and professional literature for updating knowledge, pedagogical reflection and improving teaching practice.

leximit të literaturës shkencore e profesionale për përditësimin e njohurive, reflektimin pedagogjik dhe përmirësimin e praktikave mësimore.

Punimi thekson se zotësia e leximit duhet të trajtohet si kompetencë ndërkurrikulare, zhvillimi i së cilës kërkon angazhimin e të gjithë mësimdhënësve, pavarësisht nga lënda apo profili profesional që mbulojnë. Për këtë arsye, integrimi sistematik i leximit dhe i të kuptuarit të teksteve në lëndët e përgjithshme dhe profesionale paraqitet si një qasje e rëndësishme për rritjen e efektivitetit të procesit mësimor. Njëkohësisht, zhvillimi i kompetencave të leximit te mësimdhënësit konsiderohet kusht i rëndësishëm për ndërtimin e një kulture profesionale të bazuar në kërkimin e informacionit, përdorimin kritik të burimeve dhe të nxënit e vazhdueshëm.

Në përfundim, argumentohet se forcimi i Zotësisë së leximit te nxënësit dhe mësimdhënësit mund të kontribuojë në rritjen e cilësisë së arsimit të mesëm profesional, në përgatitjen më të mirë të të rinjve për kërkesat e tregut të punës dhe në zhvillimin e një sistemi arsimor më të përgjegjshëm ndaj ndryshimeve shoqërore, teknologjike dhe profesionale.

Fjalët çelës: Zotësia e leximit, arsimi i mesëm profesional, kompetencat e nxënësve, zhvillimi profesional i mësimdhënësve, të menduarit kritik, tekstet profesionale, të nxënit gjatë gjithë jetës.

The paper argues that reading literacy should be treated as a cross-curricular competency requiring the involvement of all teachers, irrespective of subject or vocational specialism. Systematically integrating reading and text comprehension into general and vocational subjects is therefore an important means of improving teaching and learning. Developing teachers' own reading competencies is also essential to a professional culture grounded in information seeking, critical use of sources and continuous learning.

The paper concludes that strengthening reading literacy among both students and teachers can improve the quality of vocational secondary education, better prepare young people for labour-market demands and foster an education system more responsive to social, technological and professional change.

Keywords**:** reading literacy; vocational secondary education; student competencies; teachers' professional development; critical thinking; vocational texts; lifelong learning

Integrimi i inteligjencës artificiale dhe vetëbesimi profesional i mësimdhënësve

Integrating Artificial Intelligence and Teachers' Professional Self-Confidence

Esin Metlilo
Mësuese klasore, ShFMU "Emin Duraku", Prizren

Nora Korapi Kastrati
Këshilltare e Karrierës, ShFMU "Ismail Qemali", Prishtinë

Abstrakt

Qëllimi i këtij hulumtimi ka qenë të shqyrtojë marrëdhënien ndërmjet aftësive të mësimdhënësve për integrimin e mjeteve të inteligjencës artificiale në mësimdhënie dhe ndikimit të tyre në vetëbesimin profesional. Në kontekstin e transformimit digjital në arsim, inteligjenca artificiale është bërë pjesë e rëndësishme e praktikës mësimore, duke ndikuar si në aspektin pedagogjik, ashtu edhe në zhvillimin profesional të mësimdhënësve.

Vetëbesimi profesional është kuptuar si ndërveprim ndërmjet aftësive reale dhe perceptimit të mësimdhënësve për kapacitetet e tyre, i cili ka ndikuar në motivim, performancë dhe gatishmëri për inovacion pedagogjik. Integrimi i inteligjencës artificiale ka luajtur rol pozitiv në forcimin e këtij vetëbesimi dhe në përmirësimin e praktikave mësimore.

Hulumtimi ka pasur qasje cilësore dhe ka përdorur dizajnin e "Studimit të Rastit të Shumëfishtë Holistik". Grupi i studimit është përbërë nga 10 mësimdhënës në shkollat publike të Prizrenit gjatë

Abstract

This study aimed to examine the relationship between teachers' ability to integrate artificial intelligence tools into teaching and their professional self-confidence. In the context of digital transformation in education, artificial intelligence has become an important element of teaching practice, influencing both pedagogical approaches and teachers' professional development.

Professional self-confidence was understood as the interaction between teachers' actual abilities and their perceptions of their own capacities, affecting motivation, performance and readiness for pedagogical innovation. The integration of artificial intelligence was found to play a positive role in strengthening this confidence and improving teaching practices.

The research adopted a qualitative approach using a holistic multiple-case study design. The study group comprised 10 teachers working in public schools in Prizren during the 2025–2026 school

vitit shkollor 2025–2026. Të dhënat janë mbledhur përmes intervistave gjysmë të strukturuara dhe janë analizuar me analizë tematike sipas Braun dhe Clarke (2006).

Gjetjet përfundimtare të hulumtimit kanë treguar se integrimi i inteligjencës artificiale në mësimdhënie ka ndikuar pozitivisht në rritjen e vetëbesimit profesional të mësimdhënësve. Mësimdhënësit që kanë përdorur më shpesh dhe në mënyrë më efektive mjetet e inteligjencës artificiale kanë raportuar ndjenjë më të lartë sigurie në punën e tyre, rritje të motivimit profesional dhe përmirësim të praktikave pedagogjike, duke e perceptuar inteligjencën artificiale si mbështetje të rëndësishme në procesin mësimor.

Fjalët çelës: inteligjenca artificiale, mësimdhënie, vetëbesim profesional.

year. Data were collected through semi-structured interviews and analysed thematically following Braun and Clarke (2006).

The final findings showed that integrating artificial intelligence into teaching positively influenced teachers' professional self-confidence. Teachers who used these tools more frequently and effectively reported greater confidence in their work, increased professional motivation and improved pedagogical practices, viewing artificial intelligence as an important source of support in teaching and learning.

***Keywords*:** artificial intelligence; teaching; professional self-confidence.

Mësuesi si udhëheqës i padukshëm: reflektime mbi mirëqenien dhe sfidat profesionale

The Teacher as an Invisible Leader: Reflections on Well-Being and Professional Challenges

Rexhep Veliu
Mësimdhënës i gjuhës angleze (në pension), trajner dhe hulumtues i pavarur
E-mail: rexhepveliu@yahoo.com

Abstrakt

Në kontekstin e transformimeve të vazhdueshme në arsim, mirëqenia profesionale e mësimdhënësve lidhet jo vetëm me kushtet individuale të punës, por edhe me mënyrën se si institucioni e njeh, e mbështet dhe e shpërndan përgjegjësinë profesionale. Ky studim synon të analizojë marrëdhënien ndërmjet mirëqenies së mësuesit, motivimit dhe rolit të tij si "udhëheqës i padukshëm" në praktikën e përditshme pedagogjike. Studimi mbështetet në një qasje cilësore reflektuese me elemente auto-etnografike. Materiali analitik përbëhet nga episode të përzgjedhura nga përvoja profesionale e autorit, të cilat lidhen drejtpërdrejt me marrëdhëniet pedagogjike, kërkesat emocionale dhe relacionale, vendimmarrjen profesionale, bashkëpunimin dhe ndërveprimin institucional. Analiza tematike u zhvillua në tri nivele: përshkrues, interpretues dhe teorik, duke i vendosur përvojat në dialog me literaturën bashkëkohore mbi udhëheqjen e mësuesit, mirëqenien profesionale, punën emocionale dhe kërkesat e burimet e punës. Analiza identifikoi zgjerimin e rolit real të mësuesit

Abstract

Against the backdrop of continuing educational change, teachers' professional well-being depends not only on individual working conditions but also on how institutions recognise, support and distribute professional responsibility. This study examines the relationship between teacher well-being, motivation and the teacher's role as an "invisible leader" in everyday pedagogical practice.

The study employs a reflective qualitative approach with autoethnographic elements. Its analytical material consists of selected episodes from the author's professional experience directly related to pedagogical relationships, emotional and relational demands, professional decision-making, collaboration and institutional interaction. Thematic analysis was undertaken at three levels—descriptive, interpretive and theoretical—bringing professional experiences into dialogue with contemporary literature on teacher leadership, professional well-being, emotional labour, and job demands and resources.

The analysis identified an expansion of teachers' actual roles beyond formal duties, encompassing

përtej detyrave formale, duke përfshirë ndërmjetësimin, mbështetjen socio-emocionale, përshtatjen pedagogjike, komunikimin me prindërit dhe bashkëpunimin profesional. Këto përgjegjësi mund të jenë burim kuptimi dhe motivimi, por edhe burim konsumimi profesional kur mbeten të pashkruara, të padukshme ose të pambështetura institucionalisht. Studimi sugjeron se mirëqenia e mësuesit duhet të trajtohet si çështje individuale, relacionale dhe organizative, ndërsa zhvillimi profesional duhet të njohë më qartë dimensionet e padukshme të punës së mësuesit.

Fjalët çelës: mirëqenia e mësuesit, motivimi, udhëheqja e mësuesit, udhëheqësi i padukshëm, puna emocionale, zhvillimi profesional, kultura institucionale.

mediation, socio-emotional support, pedagogical adaptation, communication with parents and professional collaboration. These responsibilities may provide meaning and motivation but can also contribute to professional exhaustion when they remain undocumented, invisible or insufficiently supported institutionally. The study suggests that teacher well-being should be understood as an individual, relational and organisational concern, while professional development should recognise the less visible dimensions of teachers' work more explicitly.

***Keywords*:** teacher well-being; teacher motivation; teacher leadership; invisible leadership; emotional labour; professional development; institutional culture.

Inteligjenca Artificiale në arsimin gjithëpërfshirës: perceptimet, përvoja dhe gatishmëria e mësimdhënësve për përdorimin e saj me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore

Artificial Intelligence in Inclusive Education: Teachers' Perceptions, Experiences and Readiness to Use It with Students with Special Educational Needs

Salihe Gajtani Osmankaq, Arafat Shabani
South East Europian University

Abstrakt

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë dhe Inteligjencës Artificiale (IA), sikurse çdo fushë tjetër, ka prekur edhe atë arsimore, pa përjashtuar arsimin gjithëpërfshirës. Midis tjerash, AI ka krijuar mundësi të reja për mbështetjen e nxënësve me nevoja të veçanta arsimore (NVA). Ky studim analizon perceptimet e mësimdhënësve lidhur me mundësitë, përfitimet, kufizimet dhe kushtet institucionale për përdorimin e Inteligjencës Artificiale në arsimin gjithëpërfshirës.

Studimi përdor qasje cilësore dhe sasiore, përmes pyetësorëve, analizës dhe intervistave gjysmë të strukturuara me mësimdhënës në arsimin e parauniversitar; shkolla të rregullta dhe qendra burimore, me kampionim të rastësishëm, duke mbledhur të dhëna mbi përvojën me arsimin gjithëpërfshirës, teknologjinë digjitale dhe përdorimin e IA-së përgjatë punës me fëmijët me nevoja të veçanta.

Studimi evidenton përvojat, sfidat dhe barrierat e pjesëmarrësve lidhur me çështjet e ngritura.

Abstract

The rapid development of technology and artificial intelligence has affected education, including inclusive education. Among other advances, artificial intelligence has created new opportunities to support students with special educational needs. This study analyses teachers' perceptions of the opportunities, benefits, limitations and institutional conditions associated with using artificial intelligence in inclusive education.

The study employs a mixed qualitative and quantitative approach, using questionnaires, analysis and semi-structured interviews with pre-university teachers from mainstream schools and resource centres. Participants were selected through random sampling. The data address their experiences of inclusive education, digital technology and the use of artificial intelligence when working with children with special educational needs.

The study identifies participants' experiences, challenges and barriers. The results indicate

Rezultatet tregojnë një nivel të konsiderueshëm të përdorimit të IA-së për personalizimin e mësimit, përshtatjen e materialeve, mbështetjen e komunikimit dhe rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve me NVA. Në të njëjtën kohë, rezultatet evidentojnë një hendek ndërmjet perceptimit pozitiv për potencialin e IA-së dhe nivelit të njohurive të avancuara profesionale të mësimdhënësve. Gjetjet sugjerojnë se integrimi efektiv i IA-së në arsimin gjithëpërfshirës kërkon jo vetëm qasje teknologjike, por edhe zhvillim profesional të mësimdhënësve, udhëzime etike, politika institucionale dhe mbikëqyrje profesionale.

Fjalët çelës: inteligjenca artificiale, arsimi gjithëpërfshirës, nxënës me nevoja të veçanta, mësimdhënës, mbështetje.

considerable use of artificial intelligence to personalise learning, adapt materials, support communication and increase the participation of students with special educational needs. At the same time, they reveal a gap between positive perceptions of the potential of artificial intelligence and teachers' levels of advanced professional knowledge. The findings suggest that effective integration requires not only access to technology but also teachers' professional development, ethical guidance, institutional policies and professional supervision.

Keywords**:** artificial intelligence; inclusive education; students with special educational needs; teachers; educational support.

Planifikimi mësimor, kreativiteti dhe mirëqenia profesionale

Lesson Planning, Creativity and Professional Well-Being

MSc. Sebahate Sopjani
ShFMU "Daut Bogujevci", Fushë-Kosovë
E-mail:. sebahatesopjani2@gmail.com

Dr. sc. Arbresha Beka
ShFMU "Naim Frashëri", Prishtinë
E-mail: arbresha.vuthaj@gmail.com

Abstrakt

Planifikimi mësimor përbën një pjesë thelbësore të punës së mësimdhënësit, duke ofruar strukturë, qartësi dhe orientim në procesin e mësimdhënies. Megjithatë, në shumë kontekste arsimore, rritja e kërkesave për dokumentim dhe standarde të përcaktuara ka hapur diskutime mbi ndikimin e këtyre praktikave në kreativitetin dhe mirëqenien profesionale të mësimdhënësve. Ky punim synon të trajtojë lidhjen ndërmjet planifikimit mësimor dhe hapësirës për kreativitet, duke vënë në pah nevojën për një balancë ndërmjet kërkesave institucionale dhe lirisë profesionale, po ashtu sfidat gjatë fazës së karrierës.

Studimi është realizuar me mësimdhënës të klasave 1-5 dhe edukatorë të nivelit parafillor, duke ofruar një pasqyrë të përvojave nga fazat e hershme të edukimit parafillor dhe arsimit fillor. Hulumtimi është realizuar me qasje të kombinuar (mikse), duke përfshirë metoda sasiore dhe cilësore për analizimin e përvojave dhe perceptimeve të mësimdhënësve.

Abstract

Lesson planning is an essential aspect of teachers' work, providing structure, clarity and direction to the teaching process. However, in many educational contexts, increasing documentation requirements and prescribed standards have prompted debate about their effects on teachers' creativity and professional well-being. This paper explores the relationship between lesson planning and opportunities for creativity, highlighting the need to balance institutional requirements with professional autonomy and to consider challenges encountered at different career stages.

The study involved teachers of Grades 1–5 and pre-primary educators, providing insight into professional experiences across pre-primary and primary education. It adopted a mixed-methods approach, combining quantitative and qualitative methods to analyse teachers' experiences and perceptions.

Gjetjet tregojnë se një qasje shumë e ngurtë ndaj planifikimit mund të kufizojë fleksibilitetin në mësimdhënie, të ulë motivimin dhe të ndikojë negativisht në mirëqenien profesionale të mësimdhënësve. Në të kundërt, format e planifikimit që lejojnë përshtatje dhe reflektim krijojnë kushte më të favorshme për zhvillimin e kreativitetit, përfshirjen aktive në procesin mësimor dhe rritjen e kënaqësisë në punë.

Në kontekstin e sistemit arsimor në Kosovë, ky studim ofron kontribut empirik duke evidentuar përvojat dhe sfidat e mësimdhënësve në lidhje me planifikimin mësimor dhe ndikimin e tij në praktikën e përditshme. Punimi thekson rëndësinë e zhvillimit profesional brenda shkollës dhe bashkëpunimit ndërmjet mësimdhënësve, si mënyra që ndihmojnë në krijimin e një ekuilibri të qëndrueshëm ndërmjet strukturës dhe risisë.

Në përfundim, propozohet një qasje më e balancuar ndaj planifikimit mësimor që mbështet mirëqenien dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësimdhënësve.

***Fjalët çelës*:** planifikimi mësimor, kreativiteti në mësimdhënie, mirëqenia profesionale, mësimdhënësit, arsimi fillor dhe parafillor.

The findings indicate that overly rigid planning may constrain teaching flexibility, reduce motivation and adversely affect teachers' professional well-being. Conversely, planning approaches that allow adaptation and reflection provide more favourable conditions for creativity, active engagement in teaching and learning, and increased job satisfaction.

Within Kosovo's education system, the study offers an empirical contribution by identifying teachers' experiences and challenges relating to lesson planning and its influence on everyday practice. It emphasises school-based professional development and collaboration among teachers as ways to achieve a sustainable balance between structure and innovation. The paper concludes by advocating a more balanced approach to lesson planning that supports teachers' well-being and continuing professional development.

***Keywords*:** lesson planning; creativity in teaching; professional well-being; teachers; primary and pre-primary education.

Trajtimi i gabimeve të nxënësve si strategji pedagogjike për përmirësimin e të nxënit dhe performancës akademike

Addressing Students' Errors as a Pedagogical Strategy for Improving Learning and Academic Performance

Shkurte Morina
Mësimdhënëse në ShFMU "Mehmet Gjevori, Prishtinë
E-mail: shkurtaamorina@gmail.com

Ermira Kajtazi
Mësuese klasore në ShFMU "Mihal Grameno", Fushë-Kosovë
E-mail: ekajtazi4@gmail.com

Abstrakt

Trajtimi gabimeve të nxënësve përbën një komponent thelbësor të mësimdhënies efektive dhe ndikon drejtpërdrejt në performancën akademike dhe zhvillimin e tyre. Në qasjet bashkëkohore, gabimi konsiderohet si mundësi për të nxënë, duke e zhvendosur fokusin nga ndëshkimi drejt reflektimit dhe përmirësimit.

Ky studim synon të analizojë praktikat e mësimdhënësve në trajtimin e gabimeve, të vlerësojë ndikimin e tyre në performancën dhe motivimin e nxënësve, të identifikojë strategjitë më efektive në praktikën mësimore. Kontributi themelor i studimit qëndron në krahasimin e perceptimeve të mësimdhënësve me përvojat e nxënësve lidhur me trajtimin e gabimeve, duke evidentuar dallimet ndërmjet tyre dhe duke ofruar rekomandime praktike për përmirësimin e procesit të mësimdhënies.

Abstract

Addressing students' errors is an essential component of effective teaching and directly influences their academic performance and development. Contemporary approaches view errors as opportunities for learning, shifting the emphasis from punishment to reflection and improvement.

This study analyses teachers' approaches to handling errors, assesses their impact on students' academic performance and motivation, and identifies effective strategies in classroom practice. Its principal contribution is a comparison of teachers' perceptions and students' experiences of error handling, identifying differences and offering practical recommendations for improving teaching and learning.

Hulumtimi është realizuar me qasje të kombinuar. Mostra përfshin 100 nxënës dhe 50 mësimdhënës nga shkollat fillore në Prishtinë, të përzgjedhur përmes mostrimit të përshtatshëm. Të dhënat kuantitative janë mbledhur përmes pyetësorëve dhe analizuar me SPSS, duke përdorur statistika përshkruese dhe analiza krahasuese. Ndërsa të dhënat kualitative janë mbledhur përmes pyetjeve të hapura dhe janë analizuar me analizë tematike.

Rezultatet tregojnë se qasjet që e trajtojnë gabimin si mundësi për reflektim ndikojnë pozitivisht në performancën akademike, rrisin angazhimin dhe ulin ankthin. Feedback-u i personalizuar rezulton më efektiv në përmirësimin e gabimeve dhe reduktimin e mbingarkesës kognitive, ndërsa vlerësimi ndërmjet nxënësve nxit bashkëpunimin. Po ashtu, reagimi konstruktiv dhe modelimi nga mësimdhënësi rrisin vetëbesimin e nxënësve.

Studimi identifikon një hendek ndërmjet perceptimeve të mësimdhënësve dhe përvojave të nxënësve, duke theksuar nevojën për qasje më të diferencuara dhe të orientuara drejt nxënësit. Gjetjet ofrojnë implikime praktike për përmirësimin e mësimdhënies dhe zhvillimin profesional.

Fjalët çelës: trajtimi i gabimeve, mësimdhënie efektive, feedback, performancë akademike, motivim.

The research used a mixed-methods approach. The sample comprised 100 pupils and 50 teachers from primary schools in Prishtina, selected through convenience sampling. Quantitative data were collected using questionnaires and analysed with the Statistical Package for the Social Sciences using descriptive statistics and comparative analyses. Qualitative data were collected through open-ended questions and analysed thematically.

The results suggest that treating errors as opportunities for reflection improves academic performance, increases engagement and reduces anxiety. Personalised feedback appears more effective in correcting errors and reducing cognitive overload, while peer assessment encourages collaboration. Constructive responses and teacher modelling also strengthen pupils' self-confidence.

The study identifies a gap between teachers' perceptions and students' experiences, underscoring the need for more differentiated, learner-centred approaches. Its findings offer practical implications for improving teaching and professional development.

***Keywords*:** error handling; effective teaching; feedback; academic performance; motivation.

Roli i lidershipit dhe vlerësimit profesional në motivimin e mësimdhënësve

The Role of School Leadership and Professional Evaluation in Teacher Motivation

Vjosë Berisha
Hulumtuese e pavarur
E-mail: vjosaberisha8@gmail.com

Erza Streli
Hulumtuese e pavarur
E-mail: erza.streli6@gmail.com

Blerona Sojeva
Hulumtuese e pavarur
E-mail: bleronasojeva1@gmail.com

Fortesa Sojeva
Mësimdhënëse në American School of Kosovo
E-mail: fortesa.sojeva1@gmail.com

Abstrakt

Ky studim shqyrton marrëdhënien ndërmjet praktikave të udhëheqjes së drejtorëve të shkollave dhe motivimit të mësimdhënësve në detyrat e tyre të punës. Në studim morën pjesë 125 mësimdhënës nga shkollat fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta në Kosovë. Të dhënat u mblodhën përmes një pyetësori me pohime mbi praktikat e udhëheqjes dhe motivimin e mësimdhënësve dhe u analizuan në SPSS.

Rezultatet treguan se mësimdhënësit raportuan nivel mesatar të praktikave të udhëheqjes (M = 3.54, SD = 1.16) dhe nivel relativisht të lartë të motivimit (M = 4.57, SD = 0.60). Analiza tregoi një lidhje pozitive dhe statistikisht të rëndësishme

Abstract

This study examines the relationship between school principals' leadership practices and teachers' motivation in carrying out their professional duties. The study involved 125 teachers from primary, lower-secondary and upper-secondary schools in Kosovo. Data were collected through a questionnaire containing statements about leadership practices and teacher motivation and analysed using the Statistical Package for the Social Sciences.

The results showed that teachers reported a moderate level of leadership practices (M = 3.54, SD = 1.16) and a relatively high level of motivation (M = 4.57, SD = 0.60). The analysis identified a

ndërmjet udhëheqjes dhe motivimit (ρ = .251, p = .005). Kjo tregon se perceptimet më pozitive për praktikat e udhëheqjes shoqërohen me motivim më të lartë të mësimdhënësve.

Fjalët çelës: lidershipi shkollor, motivimi i mësimdhënësve, praktikat e lidershipit, mësimdhënësit, Kosovë.

positive and statistically significant relationship between leadership and teacher motivation (ρ = .251, p = .005). This indicates that more favourable perceptions of leadership practices are associated with higher teacher motivation.

***Keywords*:** school leadership; teacher motivation; leadership practices; teachers; Kosovo

Mentorimi dhe sfidat e mësimdhënësve fillestarë në zhvillimin profesional

Mentoring and the Challenges Facing Beginning Teachers in Professional Development

Msc. Zymer Cakolli
Mësimdhënës ShFMU "Elena Gjika", Prishtinë
E-mail: zymercakolli70@gmail.com

Nehat Duraku
Mësimdhënës ShFMU “Isa Boletini”, Rahovec
E-mail: nduraku11@gmail.com

Abstrakt

Mirëqenia profesionale dhe motivimi i mësimdhënësve janë faktorë të rëndësishëm për cilësinë e arsimit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të profesionit të mësimdhënies. Veçanërisht në fazat e para të karrierës, mësimdhënësit fillestarë përballen me sfida profesionale, pedagogjike dhe institucionale që mund të ndikojnë në performancën, motivimin dhe vazhdimësinë e tyre në profesion. Në këtë kontekst, mentorimi konsiderohet një mekanizëm i rëndësishëm për mbështetjen profesionale dhe për zhvillimin e vazhdueshëm të mësimdhënësve.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë rolin e mentorimit në mbështetjen e mësimdhënësve fillestarë dhe sfidat kryesore me të cilat ata përballen gjatë fazave të hershme të karrierës në institucionet arsimore të komunës së Prishtinës, të Rahovecit dhe të Lipjanit. Studimi synon gjithashtu të identifikojë mënyrat se si mentorimi kontribuon në zhvillimin profesional dhe në mirëqenien profesionale të mësimdhënësve.

Abstract

Professional well-being and teacher motivation are important factors in educational quality and the sustainable development of the teaching profession. Especially in the early stages of their careers, beginning teachers encounter professional, pedagogical and institutional challenges that may affect their performance, motivation and retention in the profession. Mentoring is therefore regarded as an important mechanism for professional support and teachers’ continuing development.

This study aims to analyse the role of mentoring in supporting beginning teachers and the principal challenges they face during the early stages of their careers in educational institutions in the municipalities of Prishtina, Rahovec and Lipjan. It also seeks to identify how mentoring contributes to teachers’ professional development and well-being.

Metodologjia bazohet në një qasje të kombinuar kërkimore, duke përfshirë pyetësorë me mësimdhënës fillestarë dhe drejtorë shkollash në disa shkolla të komunës së Prishtinës, të Rahovecit dhe të Lipjanit, ku janë punësuar mësimdhënës fillestarë. Mostra përbëhet nga mësimdhënësit fillestarë të punësuar gjatë tri viteve të fundit. Analiza e të dhënave synon të identifikojë sfidat kryesore të mësimdhënësve fillestarë, format e mbështetjes që ofron mentorimi dhe ndikimin e tij në zhvillimin profesional.

Rezultatet evidentojnë një vlerësim të lartë të mbështetjes institucionale dhe bashkëpunimit kolegjial. Mësimdhënësit fillestarë raportojnë nivele të larta të pranimit nga kolegët, gatishmërisë së drejtuesve për ofrimin e ndihmës dhe qartësisë së udhëzimeve profesionale. Ndërkohë, drejtorët vlerësojnë pozitivisht ndikimin e mentorimit në integrimin profesional të mësimdhënësve të rinj.

Megjithatë, rezultatet nxjerrin në pah nevojën për forcimin e dimensionit praktik dhe të vazhdueshëm të mentorimit. Mbështetja në planifikimin dhe realizimin e mësimit vlerësohet relativisht më e ulët, ndërsa mësimdhënësit shprehin nevojën për mentorim më të strukturuar dhe sistematik. Vështirësitë në menaxhimin e klasës dhe pasiguria gjatë fillimit të karrierës paraqiten si përvoja jo të njëtrajtshme ndërmjet pjesëmarrësve.

Gjetjet sugjerojnë se integrimi profesional nuk mbështetet vetëm në gatishmërinë individuale të drejtuesve dhe kolegëve, por kërkon edhe mekanizma të qëndrueshëm të mentorimit

The methodology adopts a mixed-methods approach, including questionnaires administered to beginning teachers and school principals in schools in Prishtina, Rahovec and Lipjan that have recruited beginning teachers. The sample comprises beginning teachers employed during the previous three years. The analysis aims to identify their main challenges, the forms of support provided through mentoring and its influence on professional development.

The results indicate highly positive assessments of institutional support and collegial cooperation. Beginning teachers report strong acceptance by colleagues, school leaders' willingness to help and clarity of professional guidance. School principals also assess mentoring's contribution to the professional integration of new teachers positively.

Nevertheless, the findings highlight the need to strengthen the practical and ongoing dimensions of mentoring. Support with lesson planning and delivery receives comparatively lower ratings, and teachers express a need for more structured and systematic mentoring. Difficulties with classroom management and feelings of uncertainty at the start of a career vary among participants.

The findings suggest that successful professional integration requires not only the willingness of school leaders and colleagues to provide support but also sustainable pedagogical mentoring mechanisms. At school level, the results can inform mentoring plans, classroom-management

pedagogjik. Në nivel shkolle, rezultatet ofrojnë bazë për zhvillimin e planeve të mentorimit, mbështetjen në menaxhimin e klasës dhe bashkëpunimin profesional. Në nivel komunal, ato mund të shërbejnë për koordinimin e programeve të mentorimit dhe zhvillimin e mbështetjes së përshtatur për mësimdhënësit fillestarë. Në nivel kombëtar, studimi ofron të dhëna empirike që mund të merren në konsideratë gjatë hartimit dhe përmirësimit të politikave për zhvillimin profesional dhe integrimin e mësimdhënësve të rinj.

Fjalët çelës: mentorimi, mësimdhënës fillestarë, zhvillimi profesional, mirëqenia profesionale, motivimi, mbështetja institucionale.

support and professional collaboration. At municipal level, they can guide the coordination of mentoring programmes and tailored support for beginning teachers. At national level, the study provides empirical evidence relevant to developing and improving policies on beginning teachers' professional development and integration into the profession.

Keywords: mentoring; beginning teachers; professional development; professional well-being; motivation; institutional support.

Mësimdhënia e diferencuar në planifikimet mësimore të arsimit fillor

Differentiated instruction in primary education lesson plans

Lirije Bytyqi Beqiri
Hulumtuese për kurrikula në arsimin fillor
Primary Education Curriculum Researcher
Instituti Pedagogjik i Kosovës /Kosovo Pedagogical Institute
Email: lirije.bytyqi@rks-gov.net

Abstrakt

Ky studim shqyrton përfshirjen e elementeve të mësimdhënies së diferencuar në planifikimet mësimore të mësimdhënësve të arsimit fillor në Kosovë, në raport me udhëzimet e dokumenteve zyrtare kurrikulare, përfshirë Kornizën Kurrikulare, Kurrikulën Bërthamë dhe kurrikulat lëndore. Vëmendje e veçantë i kushtohet identifikimit të nevojave dhe aftësive të nxënësve, përshtatjes së përmbajtjeve, aktiviteteve dhe detyrave mësimore, organizimit të punës në klasë, përdorimit të burimeve mësimore, vlerësimit të të nxënit dhe reflektimit të mësimdhënësve mbi praktikat e tyre.

Hulumtimi është realizuar përmes qasjes cilësore, duke përfshirë analizën e 100 planifikimeve ditore mësimore, intervistat gjysmë të strukturuara me 20 mësimdhënës të arsimit fillor dhe shqyrtimin e dokumenteve zyrtare kurrikulare. Planifikimet janë analizuar përmes një liste kontrolli, ndërsa të dhënat nga intervistat kanë shërbyer për të shqyrtuar praktikat mësimdhënësve, reflektimet e tyre mbi procesin mësimor dhe sfidat gjatë zbatimit të mësimdhënies së diferencuar.

Abstract

This study examines the inclusion of elements of differentiated instruction in the lesson plans of primary school teachers in Kosovo, in relation to the guidelines set out in official curriculum documents, including the Curriculum Framework, the Core Curriculum, and subject curricula. Particular attention is given to identifying students' needs and abilities; adapting instructional content, activities, and tasks; organizing classroom work; using teaching resources; assessing learning; and teachers' reflections on their practices.

The study employed a qualitative approach, including an analysis of 100 daily lesson plans, semi-structured interviews with 20 primary school teachers, and a review of official curriculum documents. The lesson plans were analyzed using a checklist, while the interview data were used to examine teachers' practices, their reflections on the teaching process, and the challenges encountered in implementing differentiated instruction.

Rezultatet tregojnë se mësimdhënësit përpiqen t'i përshtatin përmbajtjet, aktivitetet, detyrat dhe materialet mësimore sipas nevojave dhe aftësive të nxënësve. Në planifikime janë evidentuar forma të ndryshme të organizimit të punës dhe elemente të vlerësimit të të nxënit. Megjithatë, përshtatjet sipas niveleve të arritjeve të nxënësve nuk dokumentohen gjithmonë qartë.

Studimi thekson rëndësinë e dokumentimit më të qartë të elementeve të mësimdhënies së diferencuar, si dhe nevojën për mbështetje profesionale dhe udhëzime praktike për mësimdhënësit. Gjetjet mund të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së planifikimit mësimor dhe në zhvillimin e praktikave që u përgjigjen dallimeve individuale të nxënësve në arsimin fillor në Kosovë.

***Fjalët çelës**: mësimdhënia e diferencuar, planifikimi mësimor, arsimi fillor, dokumente kurrikulare.*

The results indicate that teachers make efforts to adapt content, activities, tasks, and instructional materials to students' needs and abilities. Various forms of classroom organization and elements of learning assessment were identified in the lesson plans. However, adaptations based on students' levels of achievement are not always clearly documented.

The study highlights the importance of clearer documentation of differentiated instruction elements, as well as the need for professional support and practical guidance for teachers. The findings may contribute to improving the quality of lesson planning and developing practices that respond to individual differences among primary school students in Kosovo.

***Keywords*:** differentiated instruction, lesson planning, primary education, curriculum documents

Transformimi digjital dhe inteligjenca artificiale në zhvillimin profesional të mësimdhënësve

Digital transformation and artificial intelligence in teachers' professional development

Agnesa Gjuraj Gashi

Abstract

Në epokën e transformimit digjital, përdorimi i teknologjisë dhe Inteligjencës Artificiale po ndikon në mënyrë të konsiderueshme në zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe në avancimin e praktikave pedagogjike. Ky studim trajton ndikimin e mjeteve digjitale dhe aplikacioneve të bazuara në Inteligjencë Artificiale në zhvillimin profesional të mësimdhënësve në arsimin fillor.

Studimi është realizuar përmes qasjes cilësore, duke përdorur intervista gjysmë të strukturuara me trembëdhjetë mësimdhënës të arsimit fillor, të përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme. Të dhënat janë shqyrtuar përmes analizës tematike.

Rezultatet evidentuan pesë tema kryesore: zhvillimin e kompetencave digjitale, përmirësimin e planifikimit mësimor, mbështetjen e reflektimit profesional, domosdoshmërinë e verifikimit kritik të përmbajtjeve të gjeneruara nga IA dhe nevojën për trajnime e mbështetje institucionale. Respodentët raportuan se përdorimi i mjeteve digjitale dhe IA-së ua ka lehtësuar përgatitjen e materialeve, kërkimin e alternativave pedagogjike dhe përshtatjen e aktiviteteve me nevojat e nxënësve. Megjithatë,

Abstract

In the era of digital transformation, the use of technology and artificial intelligence (AI) is having a considerable impact on teachers' professional development and the advancement of pedagogical practices. This study examines the impact of digital tools and AI-based applications on the professional development of primary school teachers.

The study employed a qualitative approach, using semi-structured interviews with 13 purposively selected primary school teachers. The data were analyzed using thematic analysis.

The results revealed five main themes: the development of digital competencies, improvements in lesson planning, support for professional reflection, the need for critical verification of AI-generated content, and the need for training and institutional support. Participants reported that digital tools and AI had facilitated the preparation of teaching materials, the exploration of alternative pedagogical approaches, and the adaptation of activities to students' needs. However, they identified inaccurate information

ata identifikuan pasaktësinë e informacionit dhe rrezikun e varësisë nga teknologjia si sfida të rëndësishme.

Gjetjet tregojnë se mjetet digjitale dhe aplikacionet e bazuara në Inteligjencën Artificiale mund të kontribuojnë në zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe në përmirësimin e praktikave pedagogjike. Megjithatë, përdorimi i tyre kërkon vlerësim kritik të informacionit të gjeneruar, zbatim të përgjegjshëm në procesin mësimor dhe mundësi të vazhdueshme për trajnim e mbështetje institucionale.

Fjalët çelës: transformim digjital, inteligjencë artificiale, zhvillim profesional, arsimi fillor, praktika pedagogjike.

and the risk of overreliance on technology as significant challenges.

The findings indicate that digital tools and AI-based applications can contribute to teachers' professional development and the improvement of pedagogical practices. Nevertheless, their use requires critical evaluation of generated information, responsible application in the teaching process, and ongoing opportunities for training and institutional support.

Keywords**:** digital transformation, artificial intelligence, professional development, primary education, pedagogical practices

Analizë krahasuese e standardeve dhe kritereve për vlerësimin dhe rishikimin e teksteve shkollore në Kosovë

A Comparative Analysis of Standards and Criteria for the Evaluation and Review of School Textbooks in Kosovo

Arbnesha Mexhuani
Hulumtuese për arsimin në distancë / Researcher in Distance Education
E-mail: arbnesha.mexhuani@gmail.com

Abstrakt

Ky studim trajton analizën e dy dokumenteve: standardeve dhe kritereve për vlerësimin dhe rishikimin e teksteve shkollore, me fokus në përfshirjen e kërkesave për zhvillimin e shkathtësive të shekullit XXI dhe me përputhjen e tyre me zhvillimet bashkëkohore në arsim. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT) në vitin 2011 i ka hartuar Standardet për Vlerësimin e Teksteve Shkollore, të cilat kanë shërbyer si bazë për sigurimin e cilësisë së teksteve shkollore në arsimin parauniversitar. Në kuadër të reformave të fundit arsimore, gjatë viteve 2022–2023, MAShT-i, me mbështetjen e projektit KosEd ("Support to Basic and Upper Secondary Education") ka hartuar dhe zbatuar kritere të reja për rishikimin profesional të teksteve shkollore për klasat 1–9, si dhe ka trajnuar dhe certifikuar mësimdhënës për këtë proces.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë standardet për tekstet shkollore të hartuara në vitin 2011 dhe kriteret për rishikimin e teksteve shkollore të hartuara në kuadër të projektit KosEd, me fokus në identifikimin e dallimeve ndërmjet tyre dhe të

Abstract

This study presents a comparative analysis of two sets of documents: the standards for evaluating school textbooks and the criteria for their review, focusing on the inclusion of requirements for developing twenty-first-century skills and their alignment with contemporary developments in education. In 2011, the Ministry of Education, Science and Technology (MEST) developed the Standards for the Evaluation of School Textbooks, which served as a basis for textbook quality assurance in pre-university education. As part of recent education reforms, in 2022–2023, MEST, with support from the KosEd project (Support to Basic and Upper Secondary Education), developed and implemented new criteria for the professional review of textbooks for grades 1–9 and trained and certified teachers to participate in this process.

The aim of this study is to analyse the 2011 textbook standards and the review criteria developed under the KosEd project, identify their differences and limitations, and examine how they

kufizimeve, si dhe në shqyrtimin e mënyrës se si këto dokumente i adresojnë shkathtësitë kryesore të shekullit XXI dhe zhvillimet bashkëkohore në arsim.

Realizimi i këtij studimi lidhet me ndryshimet në kërkesat e arsimit bashkëkohor dhe synon të shqyrtojë mënyrën se si standardet ekzistuese dhe kriteret për rishikimin e teksteve shkollore u përgjigjen këtyre kërkesave, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e shkathtësive të shekullit XXI. Rezultatet tregojnë se standardet dhe kriteret ekzistuese i përfshijnë në një masë të konsiderueshme shkathtësitë e shekullit XXI, ndërsa zhvillimet bashkëkohore në arsim, veçanërisht digjitalizimi, nuk janë integruar në mënyrë të mjaftueshme. Rekomandohet rishikimi dhe përditësimi i standardeve dhe kritereve për tekstet shkollore, me fokus në integrimin e shkathtësive të shekullit XXI dhe në adresimin e zhvillimeve bashkëkohore në arsim, veçanërisht të digjitalizimit.

Fjalët çelës: analiza krahasuese, standardet për tekste shkollore, kriteret për rishikim, tekstet shkollore, vlerësimi

address key twenty-first-century skills and contemporary developments in education.

The study responds to changing demands in modern education and assesses the extent to which existing standards and review criteria meet these demands, particularly in relation to twenty-first-century skills development. The findings indicate that existing standards and criteria incorporate twenty-first-century skills to a considerable extent, whereas contemporary developments in education, particularly digitalisation, have not been sufficiently integrated. The study recommends revising and updating textbook standards and review criteria, with particular emphasis on integrating twenty-first-century skills and addressing contemporary educational developments, especially digitalisation.

***Keywords*:** comparative analysis; textbook standards; review criteria; school textbooks; evaluation.

Roli i pedagogut të shkollës në zhvillimin profesional të mësimdhënësve dhe në përmirësimin e cilësisë së arsimit

The role of school pedagogues in teachers' professional development and improving the quality of education

Osman Buleshkaj

Abstrakt

Ndryshimet në sistemet bashkëkohore të arsimit kanë çuar në një rikonceptualizim të roleve dhe funksioneve të shërbimit pedagogjik, duke zhvendosur fokusin nga përgjegjësitë tradicionale administrative dhe mbikëqyrëse drejt mbështetjes profesionale për mësimdhënësit, zhvillimin institucional dhe sigurimit të cilësisë në arsim. Ky punim synon të shqyrtojë themelet teorike dhe evolucionin e profesionit të pedagogut shkollor, me theks të veçantë në rolin e tij në mentorim, reflektim dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve në shkollë. Punimi mbështetet në një analizë dhe sintezë të literaturës akademike dhe dokumenteve profesionale, duke eksploruar perspektivat teorike dhe modelet bashkëkohore të shërbimeve pedagogjike në vendet e Ballkanit Perëndimor, me vëmendje të veçantë në Kosovë.

Shqyrtimi i literaturës nxjerr në pah ndryshimin e rolit të pedagogut shkollor nga një profesionist kryesisht përgjegjës për detyrat administrative dhe mbikëqyrëse në një këshilltar, mentor, studiues dhe mbështetës të zhvillimit profesional në shkollë. Në këtë kontekst, mentorimi, mbikëqyrja, reflektimi kritik mbi praktikat e mësimdhënies dhe

Abstract

Changes in contemporary education systems have led to a reconceptualization of the roles and functions of pedagogical services, shifting the focus from traditional administrative and supervisory responsibilities towards professional support for teachers, institutional development, and quality assurance in education. This paper aims to examine the theoretical foundations and evolution of the school pedagogue profession, with particular emphasis on its role in mentoring, professional reflection, and school-based teacher professional development. The paper draws on an analysis and synthesis of academic literature and professional documents, exploring theoretical perspectives and contemporary models of pedagogical services in the Western Balkan countries, with particular attention to Kosovo.

The literature review highlights the shifting role of the school pedagogue from a professional primarily responsible for administrative and supervisory tasks into an adviser, mentor, researcher, and facilitator of school based professional development. In this context, mentoring, supervision, critical reflection on

bashkëpunimi kolegjial identifikohen si mekanizma të rëndësishëm për forcimin e kompetencave profesionale të mësimdhënësve. Në veçanti, zhvillimi profesional në shkollë konceptohet si një proces i vazhdueshëm dhe bashkëpunues, në të cilin pedagogët e shkollës kontribuojnë në identifikimin e nevojave të të nxënit profesional, koordinimin e komuniteteve të të nxënit profesional, analizimin e praktikave pedagogjike, dhe përdorimin e dëshmive për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënit.

Punimi argumenton se forcimi i rolit zhvillimor të pedagogut të shkollës kërkon kompetenca profesionale të përcaktuara qartë, më pak fokus në përgjegjësitë administrative dhe krijimin e mekanizmave të qëndrueshëm të mbështetjes institucionale. Në kontekstin e Kosovës, këto qasje ofrojnë një bazë teorike për avancimin e shërbimit pedagogjik si një mekanizëm kryesor për mbështetjen e zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit.

Fjalët çelës: shërbimi pedagogjik, mentorimi profesional, reflektimi, zhvillim profesional me bazë në shkollë, cilësia e arsimit.

teaching practices, and collegial collaboration are identified as important mechanisms for strengthening teachers' professional competencies. In particular, school-based professional development is conceptualized as a continuous and collaborative process in which school pedagogues contribute to identifying professional learning needs, coordinating professional learning communities, analysing pedagogical practices, and using evidence to improve teaching and learning.

The paper argues that strengthening the developmental role of school pedagogues requires clearly defined professional competencies, less emphasis on administrative responsibilities, and the establishment of sustainable institutional support mechanisms. In the context of Kosovo, these approaches provide a theoretical foundation for advancing pedagogical services as a key mechanism for supporting teachers' professional development and continuously improving the quality of education.

Keywords: pedagogical service, professional mentoring, reflection, school-based professional development, quality of education.

Perceptimet e nxënësve dhe të mësimdhënësve për rolin e përmbajtjeve letrare në tekstet shkollore të gjuhës shqipe në arsimin e mesëm të ulët në Kosovë

Students' and teachers' perceptions of the role of literary content in albanian language textbooks in lower secondary education in Kosovo

Safete Shala

Abstrakt

Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë perceptimet e nxënësve dhe të mësimdhënësve për rolin e përmbajtjeve letrare në tekstet shkollore të gjuhës shqipe në zhvillimin e aftësive të komunikimit te nxënësit e arsimit të mesëm të ulët (klasat 6-9) në Kosovë. Studimi fokusohet në kontributin e këtyre përmbajtjeve në zhvillimin gjuhësor, shprehjen e ideve, analizën dhe interpretimin, si dhe në vështirësitë që shfaqen gjatë procesit mësimor.

Hulumtimi mbështetet në një dizajn përshkrues me qasje të përzier, duke integruar të dhënat sasiore dhe cilësore. Të dhënat janë mbledhur përmes një pyetësori me 388 nxënës dhe intervistave gjysmë të strukturuara me 10 mësimdhënës të gjuhës dhe letërsisë shqipe nga shtatë shkolla të mesme të ulëta. Të dhënat sasiore janë analizuar përmes statistikave përshkruese, ndërsa ato cilësore përmes analizës tematike.

Rezultatet tregojnë se 39.1% e nxënësve vlerësojnë se letërsia i ndihmon shumë në zhvillimin e aftësive gjuhësore, ndërsa 48.2%

Abstract

The aim of this study is to examine students' and teachers' perceptions of the role of literary content in Albanian language textbooks in developing the communication skills of lower secondary school students (Grades 6–9) in Kosovo. The study focuses on the contribution of this content to language development, the expression of ideas, analysis and interpretation, as well as on the difficulties that arise during the teaching and learning process.

The research is based on a descriptive mixed-methods design that integrates quantitative and qualitative data. Data were collected through a questionnaire administered to 388 students and semi-structured interviews with 10 teachers of Albanian language and literature from seven lower secondary schools. Quantitative data were analysed using descriptive statistics, while qualitative data were examined through thematic analysis.

The results show that 39.1% of students believe that literature helps them considerably in developing their language skills, while 48.2%

deklarojnë se i ndihmon mjaftueshëm. Gjithashtu, 45.1% e nxënësve e konsiderojnë shprehjen më të mirë si arsyen kryesore të leximit të përmbajtjeve letrare. Megjithatë, 62.8% i vlerësojnë temat si mesatarisht interesante, vetëm 21.4% i konsiderojnë njësitë mësimore të përshtatshme për nga gjatësia dhe 38.1% deklarojnë se i kuptojnë detyrat dhe fjalët e panjohura pa ndihmën e mësimdhënësit. Ndër nxënësit që dhanë vlerësim të qartë në pyetjen e hapur, 67.5% shprehin perceptime pozitive për rolin e teksteve në të menduarit kritik dhe shprehjen e ideve.

Studimi përfundon se përmbajtjet letrare në tekstet shkollore të gjuhës shqipe perceptohen si mbështetje për zhvillimin e aftësive komunikuese, por mbeten sfida që lidhen me gjatësinë e njësive, fjalorin dhe qartësinë e udhëzimeve.

Fjalët kyçe: aftësitë e komunikimit, arsimi i mesëm i ulët, përmbajtjet letrare, perceptimet e nxënësve dhe të mësimdhënësve, tekstet shkollore të gjuhës shqipe.

report that it helps them sufficiently. In addition, 45.1% of students regard improved self-expression as the main reason for reading literary content. However, 62.8% rate the topics as moderately interesting, only 21.4% consider the lesson units appropriate in length, and 38.1% report that they understand the tasks and unfamiliar words without the teacher's help. Among students who gave a clear assessment in the open-ended question, 67.5% expressed positive perceptions of the role of the texts in fostering critical thinking and the expression of ideas.

The study concludes that literary content in Albanian language textbooks is perceived as supporting the development of communication skills; however, challenges remain regarding the length of units, vocabulary, and the clarity of instructions.

Keywords: communication skills, lower secondary education, literary content, students' and teachers' perceptions, Albanian language textbooks.

Rëndësia e aftësive të buta në mësimdhënie efektive dhe zbatimi i tyre në klasë

The importance of soft skills in effective teaching and their application in the classroom

Zehrije Plakolli

Abstrakt

Ky studim ka për qëllim të shqyrtojë rëndësinë e aftësive të buta të mësimdhënësve në ngritjen e efektivitetit të mësimdhënies dhe në zhvillimin e një nxënieje cilësore e të qëndrueshme, duke analizuar mënyrën se si këto aftësi manifestohen në praktikën mësimore dhe si ndërlidhen me angazhimin, motivimin dhe pjesëmarrjen aktive të nxënësve në klasë. Në kontekstin e arsimit bashkëkohor, cilësia e procesit mësimor nuk përcaktohet vetëm nga kompetencat profesionale dhe njohuritë lëndore të mësimdhënësit, por edhe nga aftësia e tij për të komunikuar në mënyrë efektive, për të ndërtuar marrëdhënie pozitive me nxënësit, për të krijuar një klimë mbështetëse të të nxënit, dhe për të menaxhuar aspektet sociale e emocionale të klasës.

Studimi mbështetet në një qasje cilësore, duke përdorur vëzhgimin e drejtpërdrejtë të praktikës mësimore, si metodë kryesore të mbledhjes së të dhënave. Mostra përfshiu dymbëdhjetë mësimdhënës të shkollave publike (nga arsimi i mesëm i ulët), të përzgjedhur në mënyrë të qëllimshme. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur një protokoll i strukturuar vëzhgimi, i ndërtuar mbi indikatorë që lidhen me komunikimin

Abstract

This study aims to examine the importance of teachers' soft skills in enhancing teaching effectiveness and promoting high-quality, sustainable learning. It analyses how these skills are manifested in classroom practice and how they relate to students' engagement, motivation, and active participation. In contemporary education, the quality of teaching is determined not only by teachers' professional competencies and subject knowledge but also by their ability to communicate effectively, establish positive relationships with students, create a supportive learning climate, and manage the social and emotional dimensions of the classroom.

The study employs a qualitative approach, using direct classroom observation as its primary data collection method. The purposively selected sample comprised twelve teachers from public lower secondary schools. Data were collected using a structured observation protocol based on indicators of pedagogical communication, empathy, motivation, classroom management, pedagogical flexibility, collaboration, and inclusion. The data were analysed using thematic analysis.

pedagogjik, empatinë, motivimin, menaxhimin e klasës, fleksibilitetin pedagogjik, bashkëpunimin dhe gjithëpërfshirjen. Analiza e të dhënave është realizuar përmes analizës tematike.

Rezultatet tregojnë se niveli i manifestimit të aftësive të buta ndryshon dukshëm ndërmjet mësimdhënësve. Në rastet kur u evidentuan komunikimi i hapur, mbështetja emocionale, fleksibiliteti pedagogjik dhe ndërveprimi aktiv, u vërejtën nivele më të larta të angazhimit, motivimit dhe pjesëmarrjes së nxënësve. Në të kundërt, dominimi i qasjeve tradicionale dhe i komunikimit formal u shoqërua me pjesëmarrje më të kufizuar dhe me një klimë më pak mbështetëse për të nxënë.

Studimi shpie te konkludimet se aftësitë e buta përbëjnë një komponent thelbësor të profesionalizmit të mësimdhënësit dhe ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimdhënies, mirëqenien emocionale të nxënësve, dhe efektivitetin e procesit të të nxënit. Gjetjet ofrojnë implikime të rëndësishme për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, programet e formimit fillestar dhe politikat arsimore që synojnë përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Fjalët çelës: *aftësitë e buta, mësimdhënie efektive, komunikim pedagogjik, mirëqenie emocionale, klima e klasës, angazhim i nxënësve, studim cilësor*

The findings reveal substantial variation among teachers in the extent to which soft skills are demonstrated. Where open communication, emotional support, pedagogical flexibility, and active interaction were observed, students exhibited higher levels of engagement, motivation, and participation. Conversely, the predominance of traditional approaches and formal communication was associated with more limited participation and a less supportive learning climate.

The study concludes that soft skills are an essential component of teacher professionalism and directly influence teaching quality, students' emotional well-being, and the effectiveness of the learning process. The findings have important implications for teacher professional development, initial teacher education programmes, and education policies aimed at improving educational quality.

Keywords**:** soft skills; effective teaching; pedagogical communication; emotional well-being; classroom climate; student engagement; qualitative study.

Konteksti i politikave për zhvillimin profesional të mësimdhënësve gjatë karrierës në Kosovë

The policy context of teachers' continuing professional development in Kosovo

Dr.sc. Agim Bujari
Hulumtues i pavarur në Institutin Pedagogjik të Kosovës
Independent Researcher, Kosovo Pedagogical Institute
E-mail: agim.bujari@rks-gov.net; agim.bujari@gmail.com

Abstrakt

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve gjatë karrierës përbën një komponent të rëndësishëm të politikave për përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe mbështetjen e reformave arsimore. Qëllimi i këtij studimi është të analizojë evolucionin e politikave për zhvillimin profesional të mësimdhënësve në Kosovë, zhvillimin e kornizës ligjore, strategjike dhe institucionale, si dhe koherencën e mekanizmave që mbështesin këtë proces. Studimi ka karakter cilësor, teoriko-analitik dhe mbështetet në analizën dokumentare të legjislacionit, strategjive dhe akteve nënligjore përkatëse, të plotësuara me shqyrtimin narrativ të literaturës shkencore, vendore dhe ndërkombëtare. Përmes analizës përshkruese, interpretuese dhe krahasuese, të dokumenteve, janë shqyrtuar zhvillimi i politikave, ndërlidhja e instrumenteve normative, dhe roli i mekanizmave institucionalë në mbështetjen e zhvillimit profesional gjatë karrierës. Rezultatet evidentojnë se politikat në Kosovë kanë evoluar nga një qasje e përqendruar kryesisht në aktivitete trajnuese

Abstract

Teachers' continuing professional development is an important component of policies aimed at improving educational quality and supporting education reforms. This study aims to analyse the evolution of teacher professional development policies in Kosovo, the development of the legal, strategic, and institutional framework, and the coherence of the mechanisms supporting this process. The study is qualitative and theoretical-analytical in nature, drawing on documentary analysis of relevant legislation, strategies, and secondary legislation, supplemented by a narrative review of national and international scholarly literature. Through descriptive, interpretive, and comparative document analysis, the study examines policy development, the interrelationships among regulatory instruments, and the role of institutional mechanisms in supporting continuing professional development. The findings indicate that policies in Kosovo have evolved from an approach primarily focused on training activities towards a more integrated

drejt një kornize më të integruar, e cila e ndërlidh zhvillimin profesional me licencimin, vlerësimin e performancës, zhvillimin profesional me bazë në shkollë dhe avancimin në karrierë. Analiza identifikon elemente të koherencës normative ndërmjet dokumenteve ligjore dhe strategjike, por edhe sfida që lidhen me financimin e qëndrueshëm, koordinimin ndërinstitucional, zhvillimin profesional të bazuar në nevoja dhe monitorimin e rezultateve. Përfundimet theksojnë se korniza e politikave krijon bazën për një sistem më të strukturuar të zhvillimit profesional, ndërsa funksionalizimi i mekanizmave të përcaktuar kërkon mbështetje të vazhdueshme institucionale dhe vlerësim të zbatimit të tyre në praktikë.

Fjalët çelës: licencimi i mësimdhënësve, politika arsimore, sigurimi i cilësisë, të nxënit gjatë gjithë jetës, zhvillim profesional i mësimdhënësve.

framework linking professional development with teacher licensing, performance appraisal, school-based professional development, and career advancement. The analysis identifies elements of regulatory coherence between legal and strategic documents, alongside challenges relating to sustainable financing, interinstitutional coordination, needs-based professional development, and the monitoring of outcomes. The conclusions emphasise that the policy framework provides a foundation for a more structured professional development system, while making the prescribed mechanisms fully operational requires sustained institutional support and evaluation of their implementation in practice.

Keywords: teacher licensing; education policy; quality assurance; lifelong learning; teacher professional development.

Analizë e rezultateve të hulumtimit ndërkombëtar për mësimdhënie dhe mësimnxënie (TALIS) 2024: Kosova dhe vendet e Ballkanit Perëndimor

Analysis of the results of the 2024 teaching and learning international survey (TALIS): Kosovo and the Western Balkan countries

Haxhere Zylfiu
Hulumtuese për arsim joformal
Divizioni i Kërkimeve në Arsim dhe aftësim profesional dhe Arsim për të rriturit
E-mail: Haxhere.Zylfiu@rks-gov.net

Abstrakt

Literatura shkencore e viteve të fundit thekson se mësimdhënësit dhe drejtorët e shkollave, si aktorë kryesorë në zbatimin e reformave dhe organizimin e proceseve mësimore, janë burimi më i drejtpërdrejtë i informacionit për shkollën dhe sistemin e arsimit në tërësi. Të dhënat e Kosovës në TALIS 2024 tregojnë se ata kanë qëndrime pozitive për treguesit e përfshirë në anketë. Edhe pse domethënëse dhe të rëndësishme, raportet ekzistuese për TALIS nuk ofrojnë edhe krahasime të rezultateve për shtetet në kuadër të rajoneve me kontekste të ngjashme. Qëllimi i studimit është të analizojë rezultatet e Kosovës për profilin e treguesve të TALIS 2024 që ndërlidhen me mësimdhënien dhe të nxënit dhe t'i krahasojë ato me mesataret e Ballkanit Perëndimor, për të parë pozicionimin e Kosovës në nivel rajonal. Kjo arrihet përmes integrimit të gjetjeve të dala nga analiza cilësore e raporteve të OECD-së dhe të vendeve të përfshira, si dhe nga analiza e të dhënave sasiore - dytësore/sekondare të OECD-së për tri fushat e analizuara: Të mësuarit për botën e sotme, Udhëheqja dhe autonomia e

Abstract

Recent scientific literature highlights that teachers and school principals, as key actors in implementing reforms and organizing teaching and learning processes, are the most direct sources of information about schools and the education system as a whole. Kosovo's TALIS 2024 data indicate that teachers and principals report positive perceptions across the indicators covered by the survey. Although significant and valuable, existing TALIS reports do not provide comparative analyses of results across countries within regions that share similar contexts. The aim of this study is to analyze Kosovo's results for the profile of TALIS 2024 indicators related to teaching and learning and compare them with the Western Balkans averages in order to determine Kosovo's position at the regional level. This is achieved by integrating findings from a qualitative analysis of OECD reports and reports from the participating countries with a quantitative analysis of OECD secondary data covering three areas: Learning for Today's World, Teacher Leadership and Autonomy, and Professional Relationships in School

mësimdhënësve dhe Marrëdhëniet profesionale në komunitetet shkollore. Gjetjet tregojnë se pozita e Kosovës kundrejt BP-së nuk është e njëtrajtshme, por ndryshon sipas profilit të treguesve përkatës. Rezultatet tregojnë se Kosova është më lart se mesatarja e BP-së me vetefikasitetin e mësimdhënësve, disa praktika pedagogjike dhe gjithëpërfshirëse në klasa, përdorimin e IA-së për funksione të caktuara pedagogjike, autonomi në planifikim dhe mësimdhënie, bashkëpunim me prindërit dhe kujdestarët e nxënësve, si dhe me kohën e punës së mësimdhënësve për aktivitete bashkëpunuese. Nën mesataren e BP-së rezulton të jemi me kushtet dhe burimet e punës në shkolla, mjete dhe burimeve digjitale, qasje në internet, staf mbështetës, pjesëmarrje të mësimdhënësve në vendimmarrjen për politikat, buxhetin dhe zhvillimin e shkollës etj.

Nga kjo perspektivë përfundojmë se tejkalimi i këtyre sfidave kërkon një qasje që lidh zhvillimin profesional dhe autonominë e mësimdhënësve me përmirësimin e kushteve dhe mjedisit organizativ të shkollës.

Fjalët çelës: autonomia e mësimdhënësve, Ballkani Perëndimor, bashkëpunimi profesional, mësimdhënia dhe të nxënit, TALIS 2024.

Communities. The findings indicate that Kosovo's position relative to the WB average varies across the different indicator profiles. Kosovo performs above the WB average in teacher self-efficacy, several pedagogical and inclusive classroom practices, the use of artificial intelligence for specific pedagogical purposes, autonomy in planning and teaching, collaboration with parents and guardians, and the time teachers spend on collaborative activities. By contrast, Kosovo falls below the WB average in school working conditions and resources, including digital tools and resources, internet access, and support staff, as well as in teachers' participation in decision-making concerning school policies, school budget and school development.

From this perspective, the study concludes that addressing these challenges requires an approach that links teacher professional development and autonomy with improvements in school conditions and the organisational environment.

Keywords: teachers' autonomy, Western Balkans, professional collaboration, teaching and learning, TALIS 2024.

Ndërlidhja ndërmjet metodave mësimore dhe proceseve kognitive

The relationship between teaching methods and cognitive processes

Amantina Pervizaj-Kelmendi, Lirije Bytyqi-Beqiri, Mevlude Aliu-Gashi, Sahare Reçica- Havolli & Tringa Dedi

Abstrakt

Ky studim shqyrton ndërlidhjen ndërmjet metodave mësimore dhe kushteve pedagogjike që mbështesin proceset e të nxënit në arsimin e mesëm të ulët, duke përdorur Dizajnin Universal për të Nxënit (UDL 3.0) si kornizë për analizimin e variabilitetit të nxënësve dhe fleksibilitetit të praktikave mësimore. Studimi u realizua përmes një dizajni të metodave të përziera dhe përfshiu 375 nxënës, 21 mësimdhënës dhe 21 vëzhgime të drejtpërdrejta të orëve mësimore, në klasat VI–IX, në shkolla të përzgjedhura nga shtatë rajone të Kosovës. Të dhënat u mblodhën përmes pyetësorit të nxënësve të bazuar në dimensionet e UDL 3.0, protokollit të strukturuar të vëzhgimit dhe intervistave gjysmë të strukturuara me mësimdhënësit. Të dhënat sasiore u analizuan përmes frekuencave, përqindjeve, testit Chi-square të pavarësisë (χ^2) dhe koeficientit Cramér's V, ndërsa të dhënat cilësore iu nënshtruan analizës tematike dhe u integruan përmes triangulimit. Rezultatet treguan variabilitet të qartë në preferencat e nxënësve për angazhimin, përfaqësimin dhe veprimin/shprehjen, si dhe bashkëjetesën e metodave tradicionale me

Abstract

This study examines the relationship between teaching methods and pedagogical conditions that support learning processes in lower secondary education, using Universal Design for Learning (UDL 3.0) as a framework for analysing learner variability and the flexibility of teaching practices. The study employed a mixed-methods research design involving 375 students, 21 teachers, and 21 direct classroom observations across grades 6–9 in selected schools from seven regions of Kosovo. Data were collected through a student questionnaire based on the dimensions of UDL 3.0, a structured classroom observation protocol, and semi-structured interviews with teachers. Quantitative data were analysed using frequencies, percentages, the Chi-square test of independence (χ^2), and Cramér's V, while qualitative data were subjected to thematic analysis and integrated through triangulation. The findings revealed clear variability in students' preferences regarding engagement, representation, and action and expression, alongside the coexistence of traditional teaching methods with active and flexible instructional

praktika aktive dhe fleksibile të mësimdhënies. U evidentuan asociacione statistikisht domethënëse ndërmjet angazhimit dhe përfaqësimit, si dhe ndërmjet angazhimit dhe veprimit/shprehjes, me madhësi të vogla të asociacionit. Triangulimi tregoi konvergjencë të pjesshme ndërmjet preferencave të nxënësve, perceptimeve të mësimdhënësve dhe praktikave të vëzhguara. Praktikat e mësimdhënësve përmbanin elemente të pajtueshme me UDL 3.0, por shkalla dhe vazhdimësia e zbatimit të tyre ndryshonin ndërmjet situatave dhe konteksteve të mësimdhënies. Studimi nuk i mat drejtpërdrejt funksionet neurokognitive; proceset njohëse përdoren si bazë teorike për interpretimin e rëndësisë së praktikave pedagogjike për angazhimin, përpunimin e informacionit, reflektimin dhe vetërregullimin e të nxënit.

Fjalët çelës: metoda mësimore, Dizajni Universal për të Nxënit (UDL 3.0), variabiliteti i nxënësve, angazhimi, fleksibiliteti pedagogjik, proceset e të nxënit.

practices. Statistically significant associations were identified between engagement and representation, as well as between engagement and action and expression, with small effect sizes. Triangulation revealed partial convergence among students' preferences, teachers' perceptions, and observed classroom practices. Teachers' instructional practices incorporated elements consistent with UDL 3.0; however, the extent and consistency of their implementation varied across instructional situations and contexts. The study did not directly measure neurocognitive functions; rather, cognitive processes served as a theoretical foundation for interpreting the relevance of pedagogical practices to learner engagement, information processing, reflection, and self-regulation of learning.

Keywords: teaching methods, Universal Design for Learning (UDL 3.0), learner variability, engagement, pedagogical flexibility, learning processes.

Botues/Publisher

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Kosovo Pedagogical Institute

https://ipkmasht.rks-gov.net